



**Plani i Mbrojtjes Sociale**  
**Bashkia Kukës**  
**2023- 2025**

**Përpiloi:**Lirije Gjana  
**Miratoi :** Gazmend Hallaci  
**Mbështeti Grupi punës**  
Asllan Bilali  
Elena Shehu  
Greta Kovaci  
Elsa Murataj

## TABELA E PËRMBAJTJES

### 1. HYRJJE

Qëllimi  
Metodologjia

Fq. 4- 6

### 2.KUADRI LIGJOR KU MBËSHTETET PLANI SOCIAL

Ligji 139, date 17.12.2015 “Për qevrisjen vendore”  
Ligji 121/2016 “Për shërbimet sociale”  
Ligji 57/ 2019 “ Për ndihmën ekonomike”  
Ligji 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërine e PAK”  
Ligji 9669 date 18.12.2066 ndryshuar me 47/2018 “ Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”  
Ligji 18/2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”  
Ligji 37/2017 Kodi i drejtësisë penale për të mitur  
Ligji 111/2017 “ Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti  
Ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”  
Ligji 22/2019 “ Për strehimin social”  
Ligji 75/2019 “ Për rininë”  
Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”  
Ligji 65/2016 “ Për ndërmarrjet sociale në RSH”

Fq. 8-11

### 3. SITUATA SOCIAL-EKONOMIKE BASHKISË KUKËS

Karakteristikat gjeografike dhe demografike të Bashkisë Kukës  
Popullsia sipas Njësi Administrative  
Ekonomia dhe mirëqenia në Bashkinë Kukës  
Infrastruktura arsimore dhe shëndetësore  
Papunësia dhe varfëria  
Margjinaliteti, fytyra e shpërndarja gjeografike

Fq. 12-16

### 4.ANALIZA E SITUATËS GRUPEVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME

Ndihma ekonomike  
Aftësia e kufizuar  
Dhuna në familje e ajo me bazë gjinore  
Fëmijët në nevojë për mbrojtje  
Strehimi  
Qendra e shërbimeve me bazë komunitare për fëmijët me AK  
Qendra ditore për moshën e trete  
Qendra komunitare e Terre des hommes  
Strehëza 48-orëshe për viktimat e dhunës në familje

Fq. 17-22

### 5.NEVOJAT LOKALE PËR ZBATIMIN E PLANIT SOCIAL

Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime  
Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale  
Shoqatat dhe shërbimet sociale që ofrojnë në Bashkinë Kukës  
Sfidat

Fq.23-28

### 6. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE DHE STRUKTURA E NEVOJSHME

- Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror  
- Përshkrimi i funksioneve dhe kompetencave  
Njësia e vlerësimit të nevojave e referimit

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve  
Koordinatori vendor për dhunën në familje  
Specialisti për strehimin social  
Administratori shoqëror dhe PAK  
Shefi i sektorit  
- Qendra komunitare për fëmijët me AK  
Menaxheri i qendrës  
Punonjësi social  
Psikologu  
Terapisti i të folurit (logoped)  
Terapist okupacional (Terapist zhvillimi)  
Fizioterapist  
Edukatori  
Punonjësi social në strehëzen 48 orëshe

**Fq.29-40**

## **7.FUSHA E VEPRIMIT TË PLANIT SOCIAL**

Struktura dhe burimet njerëzore  
Shërbimet sociale  
Zbutja e varfërisë  
Programe parandaluese  
Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve

**Fq.41-44**

## **8. MATRICA E PLANIT SOCIAL BASHKIA KUKËS**

**Fq. 45-56**

## LISTA E SHKURTIMEVE

BK	Bashkia Kukës
NjMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale
NGO	Organizata Jo-qeveritare
NPO	Organizata Jo-fitimprurëse
OSBE	Organizata Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian
QKL	Qendra Kombëtare e Liçensimit
RC	Këshilli i Qarkut
RATC	Komiteti Rajonal Antitrafikimi
SSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SC	Save the Children
SDC	Koperacioni Zvicëran për Zhvillim
TdH	Terres des Homes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Ndihma e ShBA-ve për Shqipërinë
ËB	Banka Botërore

## 1. HYRJE

Plani i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Kukës, i cili është i treti i propozuar, (pasi Bashkia Kukës ka hartuar dhe dy plane të tilla, 2016-2019, 2019-2022), është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse, i cili synon të adresojë nevojat për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e Njësitë të Qeverisjes Vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel lokal.

**Në ligjin Nr. 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 përcaktohen “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijimin fondin social për financimin e shërbimeve, etj. Këto funksione u shtojnë pushteteve lokale përgjegjësi të reja dhe nxjerrin në pah nevojën e një procesi gjithëpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendorë, duke shtuar këtu edhe zgjerimin e territorit dhe popullatës që Bashkia duhet të mbulojë me shërbime.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore.

Planifikimi është një komponent shumë i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të programeve dhe strategjive, i cili konsiderohet gjithashtu esenciale në gjithë veprimtarinë e organizatave, institucioneve, agjencive sociale dhe shpërndarjen e shërbimeve të ndryshme në nivel vendor.

Plani social, si dokument referent gjen mbështetje në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2021 – 2030) e cila është projektuar si një vazhdim i strategjisë së mëparshme, përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikatat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenushme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

**Plani social i Bashkisë Kukës synon:**

- A. *Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër; përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe ofrimin e shërbimeve të integruara të shtrira dhe në Njësitë Administrative,*

*përfshirjen në skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.*

- B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.*
- C. Ngritjen e shërbimeve të kujdesit social në sa më shumë Njësi Administrative, sipas nevojave të identifikuar, të cilat synojnë përfshirjen e grupeve vulnerabël (fëmijë, të rinj, gra e të moshuar) në programet e Mbrojtjes Sociale, fuqizimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit social, rritjen e cilësisë e standarteve të shërbimeve duke inkurajuar përfituesit e shërbimeve në pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri.*

Ky plan bazohet në parimet bazë të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e shtetit shqiptar:

- Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.
- Mbrojtja: Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
- E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit: Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.
- Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve: Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.
- Përfshirja dhe integrimi: Respektimi i të drejtave dhe nevojave.
- Partneriteti: koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
- Cilësia e shërbimeve: Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor. Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar këto parime duke ju referuar nevojave dhe specifikave lokale, ka shqyrtuar një spektër të gjerë të shërbimeve, kapaciteteve njerëzore, financiare dhe institucionale të Bashkisë Kukës për të ofruar këto shërbime sot dhe në të ardhmen si dhe ka ofruar rekomandime në fushat e nevojshme për ndërhyrje.

**1.1. Qëllimi i hartimit të këtij plani** është adresimi i problemeve sociale dhe buxhetimi i tyre nga ana e Bashkisë Kukës, ngritja e shërbimeve të reja në bazë të identifikimit të nevojave duke synuar shtrirjen e tyre dhe në Njësitë Administrative, fuqizimin e shërbimeve ekzistuese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve në përputhje me standardet e miratuar, e gjithë kjo në bashkëpunim dhe në partneritet me Pushtetin Qëndror dhe donatorë të ndryshëm që shfaqin interes për të financuar shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Kukës. Për realizimin e këtij qëllimi janë përcaktuar disa objektiva konkrete të cilat synojnë :

**Obj. 1.** Identifikimin e nevojave në secilën prej njësive administrative për shërbime sociale.

**Obj. 2.** Ngritjen e strukturave të pajisur me stafet e nevojshme për shërbimet sociale.

**Obj. 3.** Ofrimin e shërbimeve sociale cilësore dhe sipas standardeve

**Obj. 4.** Fuqizimin e shërbimeve ekzistuese dhe ngritjen e shërbimeve të reja komunitare në bazë të nevojave.

**Obj. 5.** Planifikimin dhe miratimin e strukturës dhe buxhetit në Bashkinë Kukës dedikuar shërbimeve sociale.

## **1.2. Metodologjia**

Nisur nga çështjet dhe pyetjet e mësipërme, ky Plan fokusohet në:

1. Vlerësimin e kapaciteteve lokale të Bashkisë Kukës për të ofruar Shërbime Sociale;
2. Në identifikimin e kuadrit ligjor, i cili rregullon Shërbimet Sociale në vijim të reformës territoriale duke identifikuar normativën për secilin target grup në nevojë që është kompetencë e Bashkisë për t'u ofruar Shërbime;
3. Në vlerësimin e kapaciteteve institucionale, materiale, financiare dhe njerëzore të pushtetit vendor, për të ofruar (prokuruar ose blerë) këto shërbime, të cilat do të adresojnë nevojat e këtij komuniteti, pas përfundimit të projektit.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti bazohet në zhvillimin e takimeve konsultative duke zbatuar një qasje meta-analitike me gjithë aktorët e mundshëm lokalë dhe atyre të shoqërisë civile. Kjo ka bërë të mundur analizën, sintezën dhe nxjerrjen e përfundimeve nga të dhënat e përftuara nga informacionet e dhëna dhedokumentet ekzistuese, siç janë: planet e zhvillimit lokal, planet buxhetore afatmesme, profili social i bashkisë etj.

Përveç kësaj procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë është bërë e mundur që nëpërmjet grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbimeve e kujdesit shoqëror dhe buxhetit-financës) të merren të dhëna mbi marrëveshjet specifike të bashkisë mbi shërbimet që ofron Bashkia Kukës.

Gjithashtu janë zhvilluar konsultime edhe me përfaqësues të institucioneve të tjera lokale dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, të cilat veprojnë në Bashkinë Kukës, me fokus ofrimin e shërbimeve sociale për target grupe të ndryshëm. Në mënyrë të hollësishme, përgatitja e këtij plani ka ndjekur hapat si më poshtë:

- o Një vështrim i plotë i politikave vendore.
- o Një inventar i shërbimeve të ofruara nga Bashkia Kukës.
- o Mbledhja e të dhënave të Bashkisë Kukës lidhur me shërbimet sociale dhe kategoritë e targetuara.
- o Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale.
- o Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor.
- o Konsultime me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për komunitetin.

## 2. KUADRI LIGJOR KU MBËSHTETET PLANI SOCIAL

### **1. Ligji 139, datë 17.12.2015 “Për qeverisjen vendore”, neni 3**

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- d) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- e) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- f) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- g) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

### **Neni 24: Funksionet e Bashkive në fushën e Shërbimeve Sociale**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nënaopoprindërmeshumëfëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

Krijimin, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

**2. Ligji 121/2016 “Për Shërbimet Sociale”,** ka për qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Kjo përcaktohet më së miri në neni 4 parimet, neni 6, përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror, neni llojet e shërbimeve, neni 26, 27, neni 36, roli i bashkive, neni 37, roli i punonjësve sociale në bashki, neni 46 mekanizmat e financimit, neni 47 fondi social.

### **3. Ligji 57/2019 Për ndihmën ekonomike.**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrësesh të shërbimeve për
- c) përmirësimin e jetesës së tyre;
- d) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- e) mirë organizimin dhe mirë funksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Ky ligj parimet bazë kryesore të tij ka universalitetin, drejtësinë sociale, mbështetjen sociale,



respektimin e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimin, kofidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave, barazinë, partneritetin.

**4. Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”** përcakton të drejtat thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara me qëllim garantimin e mundësive dhe kushteve të barabarta të tyre me të tjerët. Ndër parimet bazë të këtij ligji është dhe barazia gjinore, që siguron që gratë me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta si burrat me aftësi të kufizuara për të përfutuar të drejtat e garantuara nga ky ligj. Në aspektin institucional, ligji parashikon themelimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar si organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, të përbërë nga 17 anëtarë/anëtarë të emëruar nga Kryeministri, duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirës së kategorive të ndryshme, si aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë.

**5. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”,** i ndryshuar. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përbalueshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji datojnë në vitet 2018 dhe 2020. **Ligji 47/2018** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAE (2016) dhe nga GREVIO (2017). Njëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesa. Ndërsa, me ndryshimet e bëra njëpërmjet **Ligjit 125/2020** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcaktohen masat për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa njëpërmjet UMPMM nga Policia e Shtetit, apo njëpërmjet UMM/UM të lëshuar nga Gjykata për atë afat kohor që përcaktohet në këto urdhra, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesit, krijimi i regjistrit të UMM/UM-ve, etj. Lidhur ngushtësisht me zbatimin e këtij Ligji është edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave **nr. 327, datë 02.06.2021** “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, i cili udhëhiqet ngakëto parime:

Shërbimetë aksesueshmelehtë dhetëarritshme;

Trajtimimerespektedinjitetiviktimave;

Ndalimi i viktimizimit, riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor;

Konfidencialiteti dhembrojtjaetë dhënavepersonale;

Siguria e jetës dhe e shëndetit;

Ndalimi idiskriminimit;

Trajtimieftivdhepërkujdesje individuale;

Mbështetja dhepartneriteti.

**6. Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.** Nga vetë objekti i tij, ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës. Në këtë ligj parashikohen masa të veçanta të përkohshme për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në postet politike dhe vendimmarrëse publike, si dhe mbrojtja nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit, medias, etj. Gjithashtu parashikohet mbledhja e detyrueshme e statistikave gjinore, nga të gjitha organet shtetërore, si dhe ngritja e strukturave

dhe mekanizmeve institucionale për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

**7.Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,** ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se *çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar “masat e mbrojtjes”* që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si bullizmi, dhuna në shkollë, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktimat të trafikimit, etj.

**8.Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”**garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon ri-viktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale.

**9.Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,** ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktimat të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, etj.

**10.Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,** i ndryshuar, ku në pikën 3 të nenit 6 parashikohet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënëseve/nxënësve dhe punonjëseve/punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”.

**11.Ligji 22/2018 “Për strehimin social”,** ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

**12.Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”,** konkretisht pika 1 e nenit, 3 parashikon se: “Mbështetja dhe fuqizimi i të reja/rinjve bazohet në parimet e mëposhtme: a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi; b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të reja/rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të reja/rinjve;etj.”

**13.Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”,** ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të disavantazuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

**14.Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”**ndër të tjera synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë

ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimët, gratë viktime të dhunës dhe trafikimit, etj.

### 3. PËRSHKRIMI I SITUATËS SOCIAL-EKONOMIKE NË BASHKINË KUKËS

#### 3.1. Karakteristika gjeografike dhe demografike të Bashkisë Kukës

Nga pikëpamja gjeografike, Bashkia Kukës ka një sipërfaqe prej 933.86 km<sup>2</sup>, kufizohet në veri me Bashkinë Has, në lindje me Kosovën (Komunat Gjakovë dhe Prizren), në jug me Bashkinë e Dibrës, dhe në perëndim me bashkitë e Fushë Arrësit dhe të Mirditës. Kryeqendra e Bashkisë së Kukësit është qyteti i Kukësit.



**Popullsia** e Kukësit sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile është 59.397 banorë dhe sipas censusit është 47.985 banorë. Rreth 20% e popullsisë jeton në zonën urbane (16.719 banorë), ndërsa pjesa tjetër (rreth 31 mijë banorë) jeton në zonën rurale e kryesisht në territore malore.

Pjesa më e madhe e fshatrave të bashkisë së re (87 fshatrave) nuk janë ende të lidhura me rrugë të asfaltuara, duke krijuar distancë të konsiderueshme mes qytetit të Kukësit dhe fshatrave të zonave të thella malore. Largësia më e madhe nga qyteti i Kukësit si qendër administrative e deri në njësinë administrative më të largët është 51 km (NJA Arrën)

Bashkia e Kukësit, sipas ndarjes së re territoriale, përbëhet nga 15 njësi administrative, nga të cilat 1 urbane dhe 14 rurale. Qyteti i Kukësit ka një dendësi të popullsisë 1.013 banorë/ km<sup>2</sup> ndërsa në zonat rurale Njësitë Administrative me dendësinë më të madhe janë NJA Shtiqën dhe NJA Bicaaj përkatësisht 99 banorë/ km<sup>2</sup> dhe 71 banorë/ km<sup>2</sup>, ndërsa Njësitë e tjera Administrative kanë një dendësinë shifra të ultë.

#### Popullsia sipas Njësie Administrative

Tab.1.

Nr	Njësia Administrative	Popullsia		
		Meshkuj	Femra	Total
1	Arrën	240	222	462
2	Bicaaj	3,210	3,328	6,538
3	Bushtricë	703	712	1,415
4	GrykëÇajë	784	923	1,707
5	Kalis	439	388	827
6	Kolsh	650	600	1,250
7	Kukës	8,385	8,334	16,719
8	Malzi	1,584	1,488	3,072
9	Shishtavec	1,840	1,995	3,835
10	Shtiqën	1,820	1,618	3,438
11	Surroj	915	917	1,832

<b>12</b>	Tërthore	1,579	1,626	3,205
<b>13</b>	Topojan	916	837	1,753
<b>14</b>	Ujmisht	900	897	1,797
<b>15</b>	Zapod	1,318	1,323	2,641
	<b>Totali gjithsej</b>	<b>25,283</b>	<b>25,208</b>	<b>50,491</b>

### 3.2Ekonomia dhe mirëqenia ekonomike në Bashkinë Kukës

Qyteti i Kukësit është qendra kryesore e Bashkisë Kukës, dhe më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaç, Shtiqën, Shishtavec dhe Malzi. Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti tregtar kryesor.

Ekonomia e Bashkisë Kukësgjenerohet kryesisht nga sektorët me produktivitet të ulët. Ekonomia e kësaj Bashkie bazohet në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë që zë 33% të gjithë të vlerës së shtuar bruto për rajonin, ndërkohë që kontributi i industrisë është vetëm në nivelin mesatar për rreth 11%. Ekonomia mbizotërohet nga biznesi individual apo ai familjar dhe kryesisht është e bazuar tek tregtia e vogël. Shumica e bizneseve janë të përqendruara në qytetin e Kukësit (79%), ndërsa njësitë e tjera administrative paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Raporti i bizneseve për banorë është tepër i ulët me rreth 46 biznese për 1,000 banorë në Kukës, deri në 1 biznes për 1,000 banorë në Ujmisht dhe Grykë Çajë.

### 3.3. Infrastruktura Arsimoree shëndetësore

Bashkia Kukës ka një infrastrukturë arsimore e cila ka problematikat e veta. Megjithë përpjekjet për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e saj, në shumë njësi administrative ka godina arsimore të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

Një problematikë tjetër që ka sistemi arsimor në Kukës ka të bëjë me braktisjen e shkollës nga nxënësit. Nga të dhënat nga DAR Kukës kjo braktisje lidhet më shumë me largimin e fëmijëve bashkë me familjet e tyre drejt emigracionit, fenomen i cili ka patur kulmin e tij në vitet 2016-2018 dhe mbetet akoma mjaft shqetësues, sidomos për atë grupmoshëtë fëmijëve që i përket arsimin të mesëm.

Në shkallë Bashkie funksionojnë 39 shkolla, nga këto 30 shkolla 9 vjeçare, 2 shkolla të mesme (Kukës dhe NJA Bicaç) dhe 7 shkolla të mesme të bashkuara (NJA Malzi, Bushtricë, Shtiqën, Tërthore, Topojan, Zapod, Shishtavec). Gjithashtu funksionojnë 48 kopshte dhe 3 çerdhe vetëm në qytet.

Numri i nxënësve në shkollat e mesme 1,737 (982 qytet, 682 në Njësitë Administrative, nga të cilët 48 janë në arsimin profesional, ku 25 janë part-time). Numri i nxënësve në arsimin 9-vjeçar është 5,358 (2,672 në qytet dhe 2,686 në Njësitë Administrative). Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte e çerdhe është 1,911 (1034 në Njësitë Administrative dhe 877 në qytet).

Numri i mësuesve në shkollat e mesme 144, ndërsa në shkollat 9-vjeçare 537 dhe 15 mësues mbështetës. Numri i edukatoreve në kopshte 115 nga të cilët 55 edukatorë në Njësitë Administrative dhe 29 janë ndihmës. Po ashtu janë dhe 16 edukatore në çerdhe dhe 3 ndihmëse. Nën një analizë të të dhënave shikohet se numri i nxënësve dhe mësuesve është në numër më të madh në arsimin 9-vjeçar krahasuar me ato në arsimin e mesëm. Nga ana tjetër numri i ulët i nxënësve në arsimin e mesëm tregon se mjaft prej fëmijëve që mbarojnë arsimin e detyrueshëm nuk e shikojnë si alternativë vazhdimin e arsimin në një nivel më të lartë me synimin për të patur mundësinë e ndjekjes së shkollës së lartë. Pengesa tjetër lidhet dhe me mungesën e një infrastrukture të përshtatshme rrugore dhe mungesë transporti brenda fshatrave të Njësisë Administrative, pasi shkollat e mesme në përgjithësi janë të përqendruara në qendër të tyre.

Në gjithë territorin e Bashkisë Kukës nga të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik, funksionon një spital rajonal dhe poliklinika e specialiteteve ku ofrojnë shërbim 31 mjek, 160

infirmierë dhe 14 laborantë. Numri i qendrave shëndetësore i shtrirë në njësitë administrative është 11 dhe 71 ambulanca me një personel prej 25 mjekë dhe 96 infermierë.

### 3.4.Papunësia dhe varfëria

Niveli i papunësisë në Bashkinë Kukës është i lartë. Të dhënat e Censurit 2011 tregojnë një nivel papunësie në masën 50% të forcave të afta për punë. Papunësia është më e lartë tek të rinjtë me një nivel prej 66%.

Pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në sektorët e tregtisë dhe shërbimeve (57.3%) ndërsa rreth 33% në sektorin e bujqësisë dhe vetëm 9.5% në sektorin e industrisë. Punësimi tek të tretë, ndeshet në zonën e qytetit dhe në njësitë administrative Kolsh, Ujmisht dhe Zapod. Ndërsa vetë-punësimi ose punësimi në ekonomitë familjare është më i shpeshtë në njësitë administrative Arrën, Shishtavec dhe Bushticë.

Sipas Agjencisë Kombëtare të punësimit, Dega Rajonale Kukës numri i personave si punë kërkuar të pa punë, të regjistruar për periudhën 2019-2022 është rreth 15.956 individë. Numri i përfutuesve nga programe të ndryshme punësimi, po për të njëjtën periudhë është 305 individë. Numri i individëve të trajnuar në qendrën e formimit profesional për periudhën 2019-2022 është 103 individë kryesisht në rrobaqepësi e parukeri dhe aktualisht ka një kërkesë prej 50 individësh që duan të ndjekin kurset e formimit profesional.

**Tab.2**

Viti	Programet		
	Nr. punëkërkuarve	Programe punësimi	Formimi profesional
2019	3,437	166	43
2020	4,788	72	20
2021	3,521	52	14
2022	4,200	15	26

*Burimi i informacionit : Agjencia Kombëtare e Punësimit, Drejtoria Rajonale Kukës*

Bashkia Kukës ka një numër të lartë familjesh të cilat mbështeten me ndihmë ekonomike. Në Bashkinë Kukës mbështeten me ndihmë mujore mesatare prej 5,600 lekësh në muaj rreth 4928, rreth 314 familje trajtohen me fondin 6% ose 33 % e familjeve që jetojnë në këtë bashki. Familjet me fëmijë përbëjnë 66 % e familjeve të varfra që mbështeten me të ardhura, familjet me një anëtar me aftësi të kufizuar përbëjnë 10%, dhe familje të drejtuar nga gra 7%. Për 100 % të familjeve në ndihmë ekonomike, arsyeja e varfërisë është e lidhur me papunësinë e mbajtësve të familjes, me pagesë pa aftësi trajtohen 2,951 individë.

**Tab.3**

Njësitë administrative dhe NJA qendër	Persona me aftësi të kufizuara	Numri i Grave ne nevojë	Nr. i të moshuarve	Gjithsej familje Ndhimë Ekonomike
Kukës	1,324	634	1,846	1,268
Malzi	160	150	430	300
Bicaj	275	340	528	681
Ujmisht	104	143	230	286
Tërthore	162	192	131	384
Shtiqën	192	207	551	414
Zapod	114	143	1,127	286
Shishtavec	158	173	795	347
Topojan	135	111	338	222

<b>Bushtricë</b>	65	79	191	159
<b>Surroj</b>	76	58	1,100	116
<b>Arrën</b>	15	31	256	61
<b>Kolsh</b>	65	69	639	139
<b>Kalis</b>	43	39	426	79
<b>Grykë-Çajë</b>	63	86	221	173
<b>TOTALI</b>	<b>2,951</b>	<b>2,455</b>	<b>8,809</b>	<b>4,863</b>

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Kujdesit Shoqëror*

### 3.5. Margjinaliteti në Bashkinë Kukës, fytyra e tij dhe shpërndarja gjeografike

Margjinaliteti është një koncept që lidhet me ekspozimin e individit apo grupeve ndaj rreziqeve dhe pamundësisë së tyre për t'i përballuar ato. Individët apo grupe të marginalizuara kanë pak ose aspak kontroll mbi jetën dhe burimet që ju mundësojnë një jetesë normale. Ata gjithashtu janë në "kurthin" e një rrethi vicioz ku mundësia për mbështetje apo marrëdhënie pozitive me pjesën tjetër të shoqërisë pothuajse mungon dhe ata janë të "penguar" për të marrë pjesë në jetën ekonomike e sociale e jetojnë në izolim.

Individët dhe grupet e marginalizuara manifestojnë disa karakteristika të përbashkëta: ata vuajnë diskriminimin dhe varësinë nga të tjerët; ata manifestojnë sjellje të cilat janë të kundërshtueshme/të pa-pranueshme nga pjesa dominante e popullsisë; kanë tendencë që të përfshihen vetëm brenda grupit që i përkasin.

#### *Cilat janë grupet e marginalizuara në Bashkinë Kukës?*

Nga takimet e zhvilluara në terren nga specialistët e shërbimeve sociale si dhe të dhënave të grumbulluara në bashkëpunim me administratorët social të NJA, janë identifikuar disa grupe të cilat manifestojnë eksperiencë sistematike përjashtimi social: fëmijë të varfër, fëmijë në konflikt me ligjin, të rinj të papunë, përdorues të pijeve alkoolike dhe lëndëve narkotike, gra e vajza me histori dhune në familje apo trafikimi si dhe gra kryefamiljare me probleme, persona me aftësi të kufizuara dhe të moshuar të vetmuar.

Shkaqet e të qënurit të përjashtuar, i gjejmë në pabarazitë që karakterizojnë shoqërinë si edhe në dobësinë e institucioneve sociale (familjes, ekonomisë, shtetit, arsimit) për të plotësuar nevojat sociale bazë.

Fëmijët e familjeve të varfra vuajnë varfërinë ekonomike të shoqëruar me një sërë problemesh sociale, duke filluar nga braktisja e shkollës, punësimi në moshë të njomë, shfrytëzimi, martesat në moshë të hershme, dhuna e risku i lartë për trafikim.

Gratë dhe vajzat e dhunuara apo në rrezik trafikimi, shoqërohen me probleme të shumta sociale dhe ekonomike, të paragjykuara nga opinioni. Shpesh ato përballen me vështirësi sociale duke mos arritur të menaxhojnë jetën e tyre, nuk mund të kenë një punë për shkak të mungesës së aftësive profesionale për të siguruar një punë. Po ashtu shpesh gratë dhe vajzat kryefamiljare, të mbijetuara nga dhuna dhe rrezik trafikimi, përballen gjithashtu me mungesën e strehimit duke u detyruar të jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe të pa sigurt.

Të rinjtë e papunë vuajnë mungesën e një punësimi, vuajnë mungesën e të ardhurave sistematike dhe janë risk për përfshirje në veprime të paligjshme apo për të qenë viktimëpotenciale të trafikimit. Mungojnë ambientet kreative, sportive dhe kulturore që do ndihmonin të rinjtë që të afroreshin më shumë në aspektin shoqëror me anëtarë të tjerë të komunitetit, duke patur në fokus dhe përfshirjen e tyre në sa më shumë aktivitete vullnetare apo kurse profesionale në ngritje të kapaciteteve të tyre profesionale.

Të qënurit individ me aftësi të kufizuara do të thotë të jesh në atë kategori që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime, që në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore e të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë

dhe efikase të tyre në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Të jesh një i moshuar i vetmuar apo i braktisur do të thotë të jesh një individ me pamundësi për të bërë një jetë normale, pasi për shkak të moshës shfaq probleme në lëvizje, në blerjen e ushqimeve, kësaj i shtohen dhe problemet shëndetësore që ato mund të kenë.

#### **4. ANALIZA E SITUATËS E GRUPEVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TËKUJDESIT SHOQËROR**



**4.1. Ndhimja Ekonomike** referuar ndryshimeve ligjore, tanimë bazohet në një *Sistem Elektronik Aplikimi dhe Vlerësimi* mbi bazën e disa variablave të përcaktuar si indikatorë të nivelit të varfërisë dhe ballafaqimit të tyre në mënyrë elektronike me të dhënat e institucioneve të lidhura me këtë proces.

Bazuar në ndryshimet ligjore dhe VKM nr.904 datë 12.12.2012 kanë të drejtë të aplikojnë për ndihmë ekonomike të gjitha familjet banorë të territorit të bashkisë. Por përfitojnë apo vlerësohen si përfitues nga ky sistem familjet pa të ardhura nga punësimi, nga sistemi i pensioneve, nga aktiviteti ekonomik privat apo nga pasuria.

Të dhënat e institucioneve të tilla si: Shërbimi i Punësimit, Sigurimeve Shoqërore, Tatim-taksave, Zyrës së Pronave dhe Drejtorisë së Transportit kryqëzohen në mënyrë elektronike me të dhënat e tjera të çdo familje aplikanti.

Aplikimi për ndihmën ekonomike bëhet pranë çdo njësie administrative apo lagje qyteti nga data 1-10 e çdo muaji. Pas kësaj bëhet vlerësimi elektronik dhe ballafaqimi me të dhënat e institucioneve nga Shërbimi Social Shtetëror dhe në fund të çdo muaji Drejtoria Rajonale e Sh.S.Sh sjell vendimin përkatës për familjet përfituese dhe masën e pagesës.

Sipas të dhënave të Drejtorisë Shërbimit Social e Kujdesit Shoqëror, Bashkia Kukës situata e përfituesve të ndihmës ekonomike për 4 vitet e fundit paraqitet si më poshtë:

#### 4.2. Familjet përfituese të ndihmës ekonomike

Tab.4.2.1

Viti	Numri mesatar i familjes në ndihmë ekonomike	Fonde faktike vjetore	Paga mesatare e familjeve
2019	5,041	2,878,0919	5.600
2020	4,928	2,853,2965	5.700
2021	4,823	2,780,7348	5.600
2022	4,814	3,681,4088	5.600

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Kujdesit Shoqëror -Pagesa llogaritet sipas strukturës së familjes si më poshtë:*

Kryefamiljarin dhe personin mbi moshë pune me 1,980 (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj;

Anëtarin në moshë pune të familjes me 1386 (njëmijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtëdhjetë) lekë;

Anëtarin nën moshë pune 990 (nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

*Përveç kësaj trajtohen:*

Fëmijët me status jetimi 3000 (tremijë) lekë;

Viktimat e dhunës dhe trafikimit 9000 (nëntëmijë ) lekë;

Fëmijët e lindur si trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë 3000 (trembje ) lekë;

Familjet kujdestare të fëmijëve jetimë 9000 (nëntëmijë) lekë, 25.000 lekë/vit për shpenzime veshmbathje, materiale shkollore

Kompensim për energjinë elektrike 1288 (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë ) lekë;

Për fëmijët në arsimin e detyruar 300 (treqind) lekë për çdo fëmijë;

Për vaksinimet e fëmijëve 100 (njëqind) lekë për çdo vaksinë.

Sipas ndryshimit të fundit ligjor përfitimi i ndihmës ekonomike do të jetë i kufizuar në kohë deri në 5 vjet.

Ndhimja ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptar, të cilëve ju mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Vihet re një diferencë midis numrit të kërkesave dhe përfituesve të skemës bazë të ndihmës ekonomike, sidomos në tre vitet e fundit. Kjo diferencë është plotësuar nëpërmjet një fondi të veçantë të Bashkisë Kukës. Trendi i kërkesës dhe mbulimit ndër vite të familjeve në nevojë për ndihmë ekonomike nga fondet e Bashkisë ka ardhur në rritje, por vlen të theksohet se diferenca

midis tyre nuk është domethënëse, pra vetëm pak familje mbeten pa u mbuluar me këtë lloj ndihme.

#### 4.3. Familjet përfituese të ndihmës ekonomike nga Bashkia-Kukës

Ndihma Ekonomike e dhënë nga Bashkia është një procedurë e përcaktuar edhe në ligj dhe e diktuar nga varfëria dhe papunësia lartë si dhe nga problemet sociale nga më të ndryshmet si dhe nga kushtëzimi i përdorimit të 3% të fondit të deleguar.

Gjatë viteve 2019-2022 Këshilli bashkiak ka vënë në dispozicion rreth 1.6 milion lekë për këtë qëllim dhe nga këto fonde kanë përfituar rreth 400 familje shumë të varfra e me probleme sociale që nuk përfitojnë nga programi elektronik i ndihmës së zakonshme.

**Tab.4.3.1**

Viti	Numri i familjeve përfituese	Fondi i akorduar
2019	319	1,215,180
2020	464	1,711,444
2021	430	1,546,140
2022	436	1,844,430

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Kujdesit Shoqëror*

#### 4.4. Aftësi e kufizuar

Përfshin në programin e saj dhënien e pagesave cash për personat e përcaktuar nga komisioni përkatës (KMCAP) me aftësi të kufizuar nga ana fizike dhe mendore që nuk lidhen me shkaqe punësimi,) që funksionon pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore. Baza ligjore VKM nr.618 datë 7.09.2006.

Për personat me kufizime të rënda përfitohet pagesa edhe për një kujdestare (Grupi i parë).

Pagesat për shkak të verbërisë.

Baza ligjore VKM nr.277 datë 18.06.1997 “Përfitimet nga statusi i të verbrit”.

Vlerësimi i nivelit të aftësisë së tyre bëhet nga KMPV që funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Pagesat për personat paraplegjike dhe tetraplegjike.

Këta persona trajtohen mbi bazën e VKM nr.31 datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit para e tetraplegjike”.

Vlerësimi i tyre bëhet nga KMCAP vendore dhe konfirmohen nga Shërbimi Social Shtetëror (persona që nuk lëvizin për shkak mosfunksionimit të dy anësive ose të katër anësive).

Lidhur me programin e pagesave Cash të invaliditetit për Bashkinë e Kukësit nuk ka një rritje të ndjeshme të numrit të përfituesve nga viti në vit.

**Tab.4.4.1**

Vitet	Nr. e personave me AK	Fondet nga Buxheti i Shtetit
2019	3.100	2,529,4991
2020	3.094	2,629,3561
2021	3.065	2,580,5454
2022	2.951	2,456,1065

*Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Kujdesit Shoqëror*

#### 4.5. Strehimi

Programi i strehimit për Bashkinë e Kukësit ka filluar të zbatohet në vitin 2016 duke ofruar

vetëm banesat me kosto të ulët. Me fonde të Entit Kombëtar të Banesave janë ndërtuar 2 pallate me 75 apartamente. Numri i kërkesave për të përfitur nga programet e strehimit është 470 familje, nga të cilët janë përzgjedhur sipas kriterëve të përcaktuara 70 familje. Gjithashtu një ndikim në zbutjen e strehimit ka patur dhe shoqata Jetimët e Ballkanit e cila ka ndërtuar rreth 30 banesa në Njësi Administrative për familjet në nevojë, kryesisht familje me fëmijë jetimë.

#### 4.6. Dhuna në familje dhe ajo me bazë gjinore

Të dhënat nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Koordinatorit Vendor të Bashkisë tregojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara dhe referuara pranë mekanizimit të referimit të rasteve të dhunës në familje (gjykata, policia, prokuroria, etj.), për periudhën 4 vjeçarekanë ardhur në rritje. Gjithashtu vihet re se është rritur numri i denoncimeve në organet e rendit nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Gjatë kësaj periudhe shënohen rreth 100 raste të raportuara si viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare. Shërbimet nga të cilat kanë përfitur viktimat e dhunës në familje ndër vite paraqiten si më poshtë:

Tab.4.6.1

Viti	Këshillim Psikologjik	Mbështetje ligjore	UM	Largim i dhunuesit	Largim i viktimës
2019	16	5	16	3	2
2020	30	17	30	5	2
2021	31	23	31	5	6
2022	24	14	20	5	0

Burimi i informacionit: Koordinator vendor për dhunën në familje

#### 4.7. Fëmijë në nevojë për mbrojtje

Nga të dhënat që disponon punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, numri i fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje ka ardhur në rritje. Ndryshimet e reja ligjore kanë nxjerrë si prioritet trajtimin e fëmijëve duke patur në konsideratë interesin më të lartë të tyre. Ndryshime ka patur dhe në kodin penal për të miturit, ku rëndësi i jepet trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin me qëllim rehabilitimin e tyre dhe riintegrimin në shoqëri.

Tab.4.7.1

Viti	Nr. Fëmijëve në nevojë për mbrojtje	Me probleme social ekonomike	Fëmijë me AK	Dhunë dhe abuzim	Viktima të mundshme trafikimi	Në konflikt me ligjin
2019	48	48	1	6	4	8
2020	37	37	0	5	3	15
2021	54	54	0	10	1	31
2022	51	51	0	2	1	38

Burimi i informacionit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Kujdesit Shoqëror

#### 4.8. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror

Shërbimet e përkujdesit shoqëror të Bashkisë së Kukësit janë të përqendruara kryesisht në

zonën urbane të territorit të Bashkisë dhe ofrohen për kategoritë më në nevojë, kryesisht shërbime ditore për të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara dhe të rikthyer nga emigracioni. Shërbimet sociale në Bashkinë Kukës janë ngritur me fonde të Bankës Botërore në vitin 2007 dhe më pas janë mbështetur nga Bashkia dhe donator të ndryshëm të cilët kanë operuar në Kukës duke ofruar shërbime për grupet në nevojë. Në vitin 2009 këto shërbime janë licencuar si shërbime komunitare dhe që nga ajo periudhë vazhdon të funksionojë shërbime ditore dhe komunitare sipas nevojave dhe donacioneve të dhëna. Këto shërbime ofrohen si nga institucione publike ashtu edhe nga OJF-të:

Kapaciteti i këtyre shërbimeve paraqitet si më poshtë:

**Tab.4.8.1**

Nr.	Emërtimi Qendrës/OJF-së	Ditore	Rezidenciale	Ditore&Rezidenciale	Publike	Jo publike	Kapaciteti Max	Kapaciteti aktual	Mosha 0-6	Mosha 7-14	Mosha 14-21	Mbi 21
1.	Qendra komunitare për fëmijët me AK 2-20 vjeç	X			X		80	48	26	10	9	
2.	Qendra Ditore për të moshuar	X			X		75	63				
3.	Qendra Komunitare e org. Terre des Hommes	X				X	100	84 fami lje		57		62 indi vidë

#### **4.9. Qendra e Shërbimeve me bazë Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara**

Është ngritur nga organizata Save the children, mbi shërbimin ekzistues i cili është ngritur në vitin 2008 dhe 2018 me projekte të Ased Zvicër dhe Fondacioni Fëmijët Shqipëtarë. Gjatë viteve 2008-2017 në këtë qendër kanë marrë shërbim rreth 12-16 fëmijë me aftësi të kufizuara. Pas rikonstruksionit, këtij shërbimi ju shtuan dhe ambiente të tjera të reja, duke synuar ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe sipas standardeve të kërkuara, të miratuara nga organet qëndrore. Po ashtu në këtë qendër u punësua dhe një staf profesionistësh të fushës i përbërë nga psikologë, logopedë e terapistë okupacionalë të cilët iu nënshtruan dhe një trajnimi disa mujor për ngritjen e kapaciteteve të tyre në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Tab.4.9.1**

Viti	Grup mosha						Diagnoza					
	2-6 vjeç		6-14 vjeç		14-21 vjeç		Crreg. Spektrit autik		Sindromëdawn		Probleme të tjera	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
2019	10	4	3	0	1	7	10	3	1	0	4	7
2020	12	4	4	1	1	7	10	3	1	0	7	8
2021	16	4	5	2	1	7	13	3	1	0	9	9
2022	28	8	7	3	1	8	13	3	1	0	15	13

Në kuadër të gjithëpërfshirës së fëmijëve me AK në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm, sipas DAR

Kukës, situata e fëmijëve me AK që ndjekin shkollën është si më poshtë:

**Tab.4.9.2**

Viti shkollor	Arsimi 9 vjeçar		Arsimi I mesëm		Totali	
	M	F	M	F	M	F
2019-2020	54	25	6	6	60	31
2020-2021	58	28	5	2	63	30
2021-2022	54	25	6	6	60	31

#### **4.10. Qendra ditore për të moshuar**

Kjo qendër funksionon që nga dhjetori i vitit 2008 dhe është ngritur me fonde të vetë Bashkisë. Qendra shërben si një vend argëtimi dhe edukimi për moshën e tretë. Të moshuarve u është vënë në dispozicion një ambient i konsiderueshëm dhe me kushte të mira për të kaluar kohë cilësore me njëri-tjetrin. Nga ana e Bashkisë, të moshuarve u është vënë në dispozicion shtypi i ditës, janëpajisur me lojëra të ndryshme si shah e domino. Gjithashtu zhvillohen dhe aktivitete të shumta sensibilizuese me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve.

#### **4.11. Qendra komunitare e Terre des hommes**

Është ngritur nga organizata Terre des hommes në bashkëpunim me Bashkinë Kukës. Është një qendër me bazë komunitare ku gjatë viteve janë implementuar disa projekte në drejtim të mbështetjes direkte të familjeve të rikthyera nga emigracioni, trajnime për individët, disbursim për punësimin. Po ashtu në këto programe janë përfshirë dhe fëmijët e familjeve duke organizuar aktivitete të shumta psiko-sociale në klasat passhkollore, me grupe mbështetëse dhe klase prindërore.

Po ashtu në projektin kundër trafikimit i mbështetur nga UNICEF janë zhvilluar aktivitete informuese parandaluese, ndihmë direkte për familjet dhe përfshirje të fëmijëve në klasat passhkollore.

#### **4.12. Strehëza 48 orëshe për viktimat e dhunës në mardhëniet familjare**

Strehëza është ngritur në vitin 2021 nga fondi social i akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo strehëz ofron shërbim 48-orësh për gratë dhe vajzat viktime të dhunës me bazë gjinore nga zonat rurale të pajisura me UPM. Fondet e dhëna shkojnë për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Ky projekt i hartuar nga ana e Bashkisë Kukës do të shtrihet në tre vite duke synuar që pas tre viteve ky shërbim të kalojë në strukturë të përhershme të Bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare në strehëz kanë marrë shërbim një numër i vogël përfituesish, por janë zhvilluar aktivitete të shumta nga stafi për promovimin e kësaj strehëze në të gjitha njësitë administrative, duke shpërndarë dhe fletëpalosje ku janë pasqyruar shërbimet që ofron kjo strehëz.

Treguesit e fondeve për shërbime të Kujdesit shoqëror 2019-2022

**Tab.4.12.1**

Viti	Fondet nga Bashkia		Fondet nga Ministria		Fonde nga donatorë	
	Për pagat sig.shoqëror e të punonjësve	Për shërbime dhe organizim e të ndryshme	Për pagat sig.shoqëror e të punonjësve	Për shërbime dhe organizim e të ndryshme	Për pagat sig.shoqëror e të punonjësve	Për shërbime dhe organizim e të ndryshme
<b>2019</b>	2.553.502	-	-	-	-	-
<b>2020</b>	3.408.430			-	1.781.930	
<b>2021</b>	2.645,725		1,703,186	-	1.318.994	

## 5. NEVOJAT LOKALE PËR ZBATIMIN E PLANIT SOCIAL

### 5.1 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale

Shërbimi social i bashkisë ka bërë përpjekjet e tij maksimale për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet lokale apo dhe qendrore, por hendeku i plotësimit të këtyre nevojave është shumë i madh. Trajtimi i problemeve sociale që ka Bashkia Kukës kërkon shumë kohë për faktin se shërbimet sociale që ofrohen nga bashkia, janë shumë të pakta në krahasim me problemet sociale që janë të shumta. Prandaj hartimi i këtij Plani Social do të bëjë të mundur evidentimin e problemeve ashtu edhe mundësitë për zgjidhjen e tyre. Ky plan synon që të jetë më afër nevojave të komunitetit dhe parashtron ndërhyrjet si nga ana e institucioneve të shtetit ashtu edhe nga organizatat jo-qeveritare.

Shërbimi social i bashkisë parashikohet të marrë një vëmendje më të madhe në vazhdim për faktin se në çdo njësi administrative të ngrihen “Njësitë për Vlerësimi dhe Referimin e Rasteve” të përbërë nga sektori i pagesave cash (ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj) dhe sektori kujdesit dhe përfshirjes sociale (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve). Kjo njësi të koordinojë punën dhe me specialistë të tjera brenda shërbimeve sociale si koordinatori vendor për dhunën dhe specialisti për strehimin. Me ngritjen e kësaj njësie vetë bashkia dhe organet e saj do jenë më afër problemeve të komunitetit, me qëllim zgjidhjen e tyre.

Ngritja e kësaj njësie paraqet për bashkinë një sfidë për të bërë menaxhimin e saj sipas standarteve, nisur që tek stafi apo edhe tek shërbimet që duhet të ofrojë. Bashkia duhet të parashikojë të rrisë numrin e punonjësve në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale kryesisht rekrutimin e atyre që kanë mbaruar fakultetin e shkencave sociale dhe shkencave humane për të zgjidhur sa më shpejt që është e mundur problemet në komunitet. Punonjësit socialë do të jenë figurat profesionale në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jenë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

#### *Nevojat që paraqiten për shërbime sociale*

Shërbimet sociale ekzistuese që operojnë në bashkinë Kukës kanë kapacitete shumë herë më të ulta se nevojat që kanë fëmijët e varfër, të rinjtë e papunë e individët me aftësi të kufizuar, moshë e tretë, gratë, e theksuar kjo në zonat rurale ku këto problematika i mbulon administratori social i njësisë administrative. Megjithë zhvillimet pozitive në drejtim të shtimit të shërbimeve sociale në llojshmëri dhe kapacitete profesionale, ende ekziston një hendek ndërmjet nevojës dhe mundësive për t'i plotësuar ato; nevojës dhe përqasjes profesionale të ofruar. Ky plan social tregon se një pjesë e mirë e grupeve më në nevojë janë ende të "pa-arritshëm" nga strukturat publike të shërbimeve sociale dhe mos-integrimi i tyre mbart pasojë në të tashmen dhe në të ardhmen. Kjo veçanërisht e vërtetë në rastin e fëmijëve të varfër, fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe të rinj të papunë, të grave kryefamiljare, viktimat të dhunës dhe të moshuar të vetmuar.

Sistemi publik i mbrojtjes shoqërore është më tepër i orientuar ndaj shërbimeve monetare. Programi i ndihmës ekonomike mbështet me të ardhura familje të varfra, por niveli i pagesave vështirë se siguron mbijetesën e jo me integrimin. Nga ana tjetër varfëria dhe papunësia është e pranishme tek të rinjtë dhe individë me aftësi të kufizuara. Ajo është e lidhur ngushtë me papunësinë në nivele të larta në Kukës, nivelin e ulët arsimor, mungesën e mjeshtrërive profesionale dhe informacionin, duke stimuluar një "status quo" me varfërinë, in-aktivitetin e frustrimin.

Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre mbetet e përhershme për faktin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e viteve.

Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofrojë shërbime sa më koherente, cilësore dhe me standarte. Plotësimi i nevojave të popullatës do jetë prioritet, duke qenë se edhe nevojat ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin dhe Bashkia duhet të jetë e gatshme që të mbulojë këto nevoja me një staf të kualifikuar.

Koordinimi i programeve që ofrojnë shërbime sociale kërkon vendosjen e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve që ofrojnë shërbime sociale me qëllim arrijen e integritit maksimal të grupeve të përjashtuara sociale brenda komunitetit ku jetojnë. Mbështetja e familjes me të ardhura dhe e mbajtësve të saj me punësim i ndihmon fëmijët e varfër të jenë të mirë-ushqyer, të shëndetshëm e të arsimuar. Mbështetja e të rinjve me punësim i largon ata nga rruga, abuzimi me substanca të dëmshme apo lojëra fati, veprimet e dhunshme apo emigrimi klandestin e i rrezikshëm. Mbështetja e individëve me aftësi të kufizuar me rehabilitim dhe punësim do t'i bëjë ata të pavarur dhe pjesë aktive e shoqërisë. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis aktorëve të ndryshëm mundëson krijimin e cikleve të plota integruese për grupe në të cilat marginaliteti është kompleks, e cila arrihet vetëm me ndërhyrjen e bashkëpunimin e shumë aktorëve. Në Bashkinë Kukës Zyra e Punës, Zyrat e Kujdesit Social, Qendrat Komunitare për shërbime sociale, shërbimet e sistemitshëndetësor e OJF me aktivitet në fushat e shërbimeve sociale, duhet të organizojmë takime në afate të rregullta kohore, në të cilat të informojnë njeri-tjetrin, të koordinojnë aktivitetet e tyre apo të ndërmarrin veprime të përbashkëta në funksion të mbështetjes maksimale të grupeve të marginalizuara.

Në Bashkinë Kukës ekziston një frymë bashkëpunimi ndërmjet strukturave në vartësi të qeverisë vendore, asaj qendrore dhe organizatave jo qeveritare. Në Bashkinë Kukës funksionojnë prej disa vitesh, 3 tavolina teknike: një për fëmijët, një për gratë me probleme të dhunës si dhe tryeza antitrafik me pjesëmarrje nga tre strukturat (qeveria qendrore, qeveria lokale dhe OJF). Qëllimi i krijimit të këtyre tavolinave teknike, lidhet me koordinimin e veprimtarisë së aktoreve që ofrojnë shërbime për grup-popullatash në nevojë, shkëmbimin e informacionit, referimin e rasteve, bashkëpunim dhe mbështetje multidisiplinale. Gjatë 2019-2022 janë mbështetur fëmijë, gra, viktima trafikimi me mbështetje psiko-sociale, juridike, strehim

Tregues i bashkëpunimit mes sektorit qeveritar e joqeveritar janë edhe agnazhimi i përbashkët në projekte me financim nga qeveria lokale e donatorë të huaj. Që nga viti 2009 ka patur angazhime të përbashkëta mes sektorit qeveritar dhe jo qeveritar, në vitin 2016 mund të flitet për disa bashkëpunime me organizata si GIZ me projektin Sori, Kooperacionin Zvicerian dhe gjatë vitit 2019 me fillimin e dy projekteve të tjera për shërbime komunitare për familjet e rikthyera nga emigracioni dhe projekti tjetër për personat me aftësi të kufizuara, financuar nga organizatat Terre des Homes dhe Save dhe Children. Po ashtu në dy vitet e fundit 2021-2022 përfitimi nga dy projekte ai nëpërmjet fondit social për ngritjen e strehëzës 48 orëshe dhe me fonde të BE për ngritjen e një qendre multifunksionale për të rinj dhe viktima të dhunës.

## **5.2. Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Kukës.**

Burimet financiare për shërbimet të kujdesit shoqëror sipas ligjit 121/2016 përbehen nga a)fondet e deleguara nga buxheti i shtetit përfshirë fondin social, b) fondet nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore, c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë, d) tarifat e shërbimit për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të qeverisjes vendore.

Bashkia në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale krijon dhe administron fondin social nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standarteve e të kapaciteteve administruese të



shërbimeve ekzistuese , krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale. Ky fond nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

Fondi social përbëhet nga :

Të ardhura vjetore nga buxheti i shtetit

Financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja

Të ardhura nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror

Të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse

Të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron Bashkia

Mjetet financiare në fondin social, të përdorura në vitin fiskal ushtrimor, mbarten në buxhetin e vitit pasardhës si pjesë e fondit social

Qeveria vendore është aktor kyç, në sigurimin e shërbimeve sociale dhe kompetencat e saj janë duke u rritë hap pas hapi nëpërmjet decentralizimit. Bashkia Kukës ka bërë progres në alokimin e fondeve në fushën e mbrojtjes sociale dhe përkujdesit shoqëror nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK. Edhe me anë të vendimeve të këshillit bashkiak bashkia është e përfshirë në realizimin dhe plotësimin e nevojave që paraqet komuniteti për shërbime sociale, në dhënie e pagesave në cash për individët apo familjet në nevojë.

### **5.3. Shoqatat dhe shërbimet sociale në Bashkinë Kukës**

Në Bashkinë Kukës shërbime sociale në natyrë ofrohen edhe nga shoqëria civile, por në një numër shumë të limituar. Përfshirja e shoqërisë civile, megjithëse modeste, ka ndikuar në rritjen e llojshmërisë së shërbimeve, cilësinë dhe numrin e përfituesve në nevojë. (Nuk ka përfitues pasi OJF që operojnë në Kukës nuk ofrojnë shërbime por operojnë vetë në drejtim të aktiviteteve sensibilizuese).

Shërbimet për integrimin e grupeve të marginalizuara të ofruara në Bashkinë Kukës janë multidisiplinare dhe me elementë të informimit, ndërgjegjësimit të cilat kërkojnë mbi të gjitha motivim të veçantë dhe mjeshtëri profesionale. Aktualisht në Bashkinë Kukës nuk janë aktive asnjë OJF që operojnë në fushën e informimit dhe shërbimeve sociale. OJF-të lokale kanë kompetenca profesionale, motivim, njohuri, por ndeshen me probleme të pa-mjaftueshmërisë në burime financiare për të zbatuar në afate të gjata kohore projekte që luftojnë përjashtimin social, diskriminimin e varfërinë. Aktivizimi i OJF-ve lokale realizohet nëpërmjet donacioneve që kanë burime të ndryshme kryesisht jashtë Shqipërisë.

Margjinalizimi tregon se programet dhe strategjitë aktuale janë të pamjaftueshme apo të papërshtatshme me nevojat e fëmijëve të varfër, të rinjve të papunë e individëve me aftësi të kufizuar të cilat janë të marginalizuara e përjashtuar nga jeta sociale e ekonomike. Margjinaliteti në Bashkinë Kukës ka fytyrën e fëmijëve e familjeve që jetojnë në varfëri, të një numri të madh të rinjsh të papunë e të individëve e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Çfarë ata kanë të përbashkët është varfëria, mungesa e një banese të përshatshme e të sigurtë, diskriminimi, barriera në përfitimin e shërbimeve mbështetëse për shkak të distancave apo pengesave në akses, mungesa e shërbimeve për të cilat kanë nevojë, në zonën ku jetojnë, mangësia e mjeshtërive dhe kualifikimeve profesionale aq të nevojshme për një përfshirje ekonomike e sociale. Në më të shumtën e rasteve ata janë "të padukshëm" për statistikatat zyrtare.

Shërbimet sociale ekzistuese që operojnë në Bashkinë Kukës kanë kapacitete shumë herë më të ulta se nevojat që kanë fëmijët e varfër, të rinjtë e papunë e individët me aftësi të kufizuar. Megjithë zhvillimet pozitive në drejtim të rritjes së shërbimeve sociale në llojshmëri dhe kapacitete profesionale, ende ekziston një hendek ndërmjet nevojës dhe mundësive për t'i plotësuar ato; nevojës dhe përjasjes profesionale të ofruar.

Shërbimet për integrimin e grupeve të marginalizuara të ofruara në Bashkinë Kukës duhet të jenë multidisiplinare dhe me elemente të informimit, ndërgjegjësimit të cilat kërkojnë mbi të gjitha motivim të veçantë dhe mjeshtëri profesionale. Aktualisht në Bashkinë Kukës, nuk ka

asnjë OJF që operon në fushën e informimit dhe shërbimeve sociale. OJF-të lokale kanë kompetenca profesionale, motivim, njohuri, por ndeshen me probleme të pa-mjaftueshmërisë në burime financiare për zbatuar në afate të gjata kohore projekte që luftojnë përjashtimin social, diskriminimin e varfërinë. Aktivizimi i OJF-ve lokale realizohet nëpërmjet donacioneve që kanë burime të ndryshme e kryesisht jashtë Shqipërisë.

Janë ndërtuar partneritete jo vetëm përsa i takon bashkërendimit dhe shkëmbimit të informacionit, por ka pasur edhe disa iniciative të përbashkëta të ofrimit të shërbimeve që janë zbatuar në qytete të ndryshme, ku në përgjithësi bashkitë kanë ofruar kontribute në natyrë (d.m.th. godinat), ndërsa OJQ-të kanë siguruar kostot operative.

*OJF-të që janë të licencuara për të ofruar shërbime në Kukës janë:*

*Qendra “Integrim e Zhvillim Demokratik”, e regjistruar si qendër komunitare për mbështetjen e personave në nevojë. Është themeluar në vitin 2004 dhe që nga kjo periudhë i ka ofruar shërbimet mbështetëse për 50 fëmijë jetimë, 30 familje dhe invalidë të varfër dhe me probleme sociale, kurse profesionale 124 persona dhe 145 persona me asistencë. Ndonëse kjo qendër ka qenëaktive, aktualisht rezulton pa aktivitet në Kukës.*

*Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale, ofron shërbime të këshillimit për gratë, vajzat dhe fëmijët me probleme sociale të komunitetit. Kjo qendër është hapur në vitin 2007 dhe ka një kapacitet prej 900 klientësh, 4 punonjës që ofrojnë shërbimet dhe 23 vullnetarë që asistojnë në aktivitetet dhe shërbimet që ofrohen.*

*Observatori për të Drejtat e Fëmijës, është një entitet-jofitimprurës, si pjesë e rrjetit të shoqërisë civile që monitorin situatën e fëmijëve në vend dhe funksionon si një strukturë vëzhguese në nivel lokal, duke vepruar si një pjesë e shoqërisë civile në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, forcimi i rrjetit të Observatorëve dhe harmonizimi me vizionin, strategjinë dhe politikat e institucioneve vendore është jashtëzakonisht progres pozitiv. Kjo ndihmon në procesin e institucionalizimit të të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe të familjes. Nëpërmjet përfaqësuesve të saj në nivel rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë vendore në bashki dhe komuna, Observatori mbledh informacion mbi të dhënat nga rekordet administrative të shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera lokale.*

*Për ju Nëna dhe Fëmijë- që është një qendër që ofron shërbime ditore për fëmijë 0-3 vjeç dhe 6-14 vjeç, si edhe shërben si qendër sociale këshillimi për të rinjtë dhe familjet.*

*Organizata Terre des hommes e cila operon në Shqipëri që nga viti 1993 me projekte të shumta në disa qytete dhe që nga viti 2018 ka filluar operimin dhe në Bashkinë Kukës. Ofron shërbime për grupet vunerabël, fëmijë, familje dhe individë të rikthyer nga emigracioni me programe të shumta që ndihmojnë në riintegrimin e tyre socio-ekonomik.*

*Organizata tëndryshëm dhe të barabartë, një organizatë e cila ka operuar në Bashkinë Kukës kryesisht në ndihmë të viktimave të trafikimit por prej vitit 2021 kjo organizatë ka ofruar shërbim dhe për viktimat e dhunës në familje duke ndihmuar ato në krijimin e lehtësirave për marrjen e shërbimeve sociale si strehim të sigurtë, bonus qeraje, mbështetje ligjore, ndihmë për punësim, riintegrim, ndihmë materiale*

#### **5.4. Sfidat**

Shërbimet e përkujdesit social, të cilat kanë në fokus të tyre plotësimin e nevojave të personave në vështirësi, ndodh që përballen me një sërë vështirësish, të cilat kanë shkaqe të ndryshme dhe manifestohen ndryshe në varësi të situatave specifike.

Nga ana tjetër, konstatohet mungesë apo cilësi e dobët e të dhënave mbi nevojat, numrin dhe profilin e përfituesve potencialë, në nivel qendror, rajonal dhe vendor. Mungesa e kapaciteteve teknike në nivel vendor dhe rajonal ka të bëjë me mungesën e burimeve, pamjaftueshmërinë e buxheteve dhe dështimin e qeverisë qendrore për të ndarë burimet shtesë, për të mundësuar strukturat vendore dhe rajonale të kryejnë funksionet e tyre të transferuara.

Kështu, pavarësisht se me ndarjen e re territoriale pritej të kishte një menaxhim dhe shpërndarje më e mirë e shërbimeve të përkujdesit social, duket se “njësitë administrative janë shumë të shpërndara, kanë disa fshatra, shtëpitë e të cilëve janë një këtu e një atje” gjë kjo që ndikon në mos përqendrimin e shërbimeve. Sipas ligjeve të miratuara sëfundmi përcaktohet që të ketë 1 punonjës social për 10.000 banorë, 1 punonjës social për 3000 fëmijë, pra duket senumri i punonjësve social është i pamjaftueshëm për të mbuluar një zonë me shërbime. Nga ana tjetër, vështirësi është **aksesi në zonat më të thella** me qëllim që të kuptohen rastet e fëmijëve dhe/apo grave dhe vajzave të dhunuara dhe të bëhen pjesë e personave që duhet të marrin shërbime.

Pavarësisht këtyre sfidave, rezulton, se sfida më e madhe është ajo e financimit, pasi mungon **buxheti për mbulimin e shërbimit social** dhe mungesa e fashës së zërit të shërbimit social, gjë kjo që sjell pasiguri dhe paqëndrueshmëri në mes të ofruesve të shërbimeve. *Për vitin 2019-2022, janë buxhetuar 23 milionë lekë të vjetra financim ky i alokuar çdo vit nga transferta e pa kushtëzuar në zërin mbrojtja sociale.*

*Po ashtu gjatë periudhës 2019-2020 është financuar rikonstruksioni i qendrës komunitare për personat me aftësi të kufizuara si dhe janë mbuluar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për tre punonjës si dhe shpenzimet operative.*

*Për vitin 2021-2022 nga fondi social i alokuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbulohen shpenzimet për tre punonjës për paga, sigurime shoqërore si dhe shpenzimet operative në shumën 3.1 milion për vitin 2021.*

Duket se ndjehet nevoja për një buxhet të qëndrueshëm jo vetëm për të mbuluar pjesën e shlyerjes së detyrimeve të punonjësve, por edhe pjesën e logjistikës, transportin e punonjësve zhvillimin e trajnimeve për ngritje kapacitetesh, ngritje të shërbimeve të reja të domosdoshme, mungesa e të cilave reflektohet me mungesën e ofrimit të shërbimeve efektive dhe me cilësi.

Sfidë tjetër e identifikuar është edhe **mungesa e një baze të dhënash**, ku të ruhen të gjitha të dhënat e mbledhura nga terreni, të dhëna që identifikojnë personat në nevojë. Ndarja territoriale në Njësi Administrative e bën të domosdoshme që stafet e këtyre njësive të kenë një pasqyrim të saktë të të dhënave statistikore për territorin në juridiksion të tyre, problematikat e komunitetit dhe nevojën për shërbime për ato grupe më në nevojë brenda territorit të tyre për ti adresuar më pas pranë Bashkisë për gjetjen e mundësive për financim. Është detyrë e Bashkisë që të ngrejë dhe ofrojë shërbime për shtresat në nevojë: gratë e dhunuara, fëmijët e dhunuar, braktisur, aftësia e kufizuar, të ardhurit nga zonat e thella, familjet në nevojë ekonomike”, ndërkohë që duke marrë parasysh sfidat e mësipërme, lind pyetja se si e me çfarë do të përmbushet ky plan strategjik?

**Mentaliteti** rezulton të jetë një sfidë tjetër, i cili pengon në punën e tyre të përditshme punonjësit e Shërbimeve Sociale, pasi edhe në ato raste kur personave të përfshirë në situata dhune, kryesisht grave dhe vajzave, përpiqen t’u gjejnë punë, hasin në kundërshtime, pasi atje “*është problem që gruaja apo motra e dikujt të punojë tek dikush tjetër, përveç se tek bizneset personale familjare.*”, ndërkohë që ngritja e fasonerive duket një mundësi e mirë për fitim ekonomik, sepse kërkohen punonjës të kualifikuar.

**Mungesa e shërbimeve dhe shpërndarja territoriale** për rastet e dhunës, për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe të rinjtë është sfidë tjetër, kjo ngase situata ka mbetur vetëm në kuadrin e raportimit të këtyre rasteve, ndërkohë që “*për momentin nuk ka një zgjidhje*” konkrete. Edhe pse tashmë në Bashkinë Kukës kemi një qasje tjetër ndaj shërbimeve e cila ka ndikuar dhe në shtimin e shërbimeve të reja sic është ngritja e strehëzës emergjencës për viktimat e dhunës, përsëri viktimat e shohin si një shërbim jo efikas, pasi kërkojnë mbështetje dhe shërbime afatgjata, që i ndihmojnë ato të largohen nga mjediset e dhunshme si dhe duke ju krijuar mundësi për të bërë një jetë normale. Mungesa e fondeve për bonus qeraje apo banesa sociale është një pengesë e madhe. Vënia në dispozicion e tyre do krijonte mundësinë e ofrimit të një strehe të sigurtë gjatë procesit të rehabilitimit të viktimës apo familjeve në nevojë për mbrojtje.

Në të njëjtën mungesë zgjidhjesh qëndrojnë edhe fëmijët, që identifikohen për braktisjen e shkollës, të cilët këshillohen “*pse duhet ta ndjekin, pse është i nevojshëm edukimi etj.*”

Po ashtu përqëndrimi i shërbimeve vetëm në zonën urbane bënqë përfituesit të mos kenë mundësinë e marrjes së tyre. Shtrirja e shërbimeve me bazë komunitare, multifunksionale dhe në Njësi Administrative, do ishte një zgjidhje adekuate për tu ofruar mundësinë e marrjes së shërbimeve sa më afër zonave ku banojnë.

Pra, në këto rrethana, kuptojmë që kemi nevojë të kemi një staf profesional, i cili ka nevojë të pajiset me aftësitë apo teknikat e duhura për të menaxhuar situata të ndryshme, por dhe marrja me seriozitet e rasteve që referohen tek institucionet pjesë e mekanizmave për të ofruar shërbimin përkatës. Përgatitja e stafit mund të vijë nëpërmjet rekrutimit të profesionistëve sipas fushave përkatëse si dhe trajnimeve, të cilat aktualisht rezultojnë se nuk janë të parashikuara.

#### ***Nevojat e punonjësve lidhur me shërbimet sociale***

Sfidë tjetër, është edhe pjesa që lidhet me **personat përgjegjës për monitorimin e shërbimeve**, të cilët rezultojnë të kenë qenë jo “kompetentë për shërbimet” që ofrojnë.

Gjithashtu vërehet se fondet që alokohen si nga Ministria e linjës dhe donatorët e ndryshëm janë të fokusuara vetëm në ngritje kapacitete të stafeve apo paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative e cila theksojmë është e rëndësishme, por domosdoshmërisht duhet që këto fonde të orientohen edhe drejt ofrimit të shërbimeve konkrete mbështetëse sipas standarteve, cilësore dhe të qëndrueshme.

Për të përmbledhur pjesën e sfidave, shkurtimisht Shërbimet Sociale në Kukës, përballet me mungesë buxheti, mungesë të organizimit të strukturës sipas shërbimeve, mungesëstafi, mungesë koordinimi të strukturave paralele, mungesë e aktivitetit të organizatave jofitimprurëse, mungesë të një stafi monitorues kompetent, mungesë trajnimesh, si edhe mungesë e mjeteve logjistike, e nevojshme për realizimin e punës së tyre.

## **6.ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE E STRUKTURA E NEVOJSHME**

### **6.1.Organizimi i shërbimeve**

Ligji 121/2016 ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Ky ligj përcakton:

- a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar,
- b) procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- c) rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.

Ky ligj dhe VKM 518, datë 04.09.2018 përcaktojnë llojet dhe kategoritë përfituese të shërbimeve.

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:

- a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- d) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
- e) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
- f) dh) të moshuarit në nevojë.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve.

Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:

- a) shërbimet parashoqërore;
- b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;
- c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
- d) shërbimet shoqërore në situatë emergjence;
- e) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;
- f) shërbimet e specializuara;
- g) shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line*.

Bazuar në sa më sipër Bashkisë Kukës i del detyrë që të ketë një qasje sa më gjithpërfshirëse të ofrimit të shërbimeve duke synuar shërbime me bazë komunitare dhe multifunksionale sa më afër komunitetit dhe sipas nevojave specifike të secilës Njësi Administrative.

Puna e bërë deri tani në drejtim të thithjes së fondeve ka përmirësuar situatën e grupeve të marginalizuara kryesisht në zonën urbane, por në detyrim të Ligjit këto shërbime duhet të jenë funksionale dhe në Njësitë Administrative.

Ajo që ne synojmë me miratimin e planit të ri social ka të bëjë

1. me fuqizimin e shërbimeve, ekzistuese,
2. ngritjen e shërbimeve të reja dhe përshtatjen e atyre ekzistuese sipas nevojave për kategoritë më të rrezikuara,

3. ristrukturimin e burimeve njerëzore sipas ligjit dhe në përputhje me shërbimet që ofrohen.

## 6.2.Përshkrimi i funksioneve dhe kompetencave

Aktualisht në strukturë kemi Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror e cila është e ndarë në dy sektorë

-Sektori i Kujdesit Shoqëror

- Sektori i Shërbimeve Sociale

Ajo që propozohet ka të bëjë me një riorganizim të strukturës ekzistuese dhe ndryshime të emërtimeve të stafit në përputhje me atë që parashikon Ligji dhe sipas specialitetit që mbulon.

Këto ndryshime kanë për qëllim të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve duke synuar standartizimin e tyre në përputhje me Ligjet në fuqi si dhe të përcaktojë më së miri rolet dhe përgjegjësitë e gjithësecilit qoftë ky drejtues, specialist, punonjës shërbimesh apo personel shërbyes.

Shërbimet sociale kanë për qëllim të ofrojnë mbrojtje dhe përkujdesje për grupet e përjashtuara.

Struktura që propozohet ka të bëjë me ngritjen e një **Drejtorie për Shërbimet Sociale** e cila mbulon tërësinë e shërbimeve që ofrohen në komunitet sipas parashikimeve ligjore të ndara :

- Shërbime direkte mbështetëse në natyrë ( mallra ushqimore dhe të përdorimit të përditshëm, veshmbathje) që u jepet individëve nëqendra ditore, komunitare, multifunksionale, streheza emergjence, apo në familje.

- Shërbime të specializuara të mbrojtjes së grupeve të marginalizuara (Dhuna, mbrojtja e fëmijëve, strehimi social)

- Shërbime mbështetëse në cash (ndihma ekonomike, pagesa e invaliditetit, status jetimi, pagesa për UM dhe viktimë trafikimi)

Kjo drejtori do ketë si prioritet ofrimin e mbrojtjes sociale për grupet e marginalizuara dhe në nevojë për mbrojtje dhe ofrimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në përputhje me kërkesën dhe nevojën që paraqet përfituesi i shërbimeve.

Shërbimet sociale të organizuara në bazë të ligjit duhet të kenë të ngritura **Njësitë e vlerësimit e referimit të nevojave**. Në ligj përcaktohet se NJVNR duhet të ngrihet pranë cdo Njësie Administrative dhe në përbërje të tij duhet të ketë punonjës social, punonjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe administratori shoqëror.

Kjo Njësi duhet të mbulojë një popullsi prej 6.000-10.000 banorë dhe 3.000 fëmijë dhe detyrat e saj janë :

- a. Identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë.
- b. Vlerësimin fillestar të nevojave dhe tërësitë për individët në nevojë.
- c. Informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla.
- d. Hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes
- e. Bashkërendimin e mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimin të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm.
- f. Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit.
- g. Mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së rasteve si dhe vlerësimin për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar
- h. Hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të Bashkisë sipas përcaktimit të nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016.

Duke patur parasysh ndarjen territoriale, synojmë që kjo Njësi të riorganizohet gjatë vitit 2023 në Njësinë Administrative qendër dhe gjatë viteve 2024-2025 edhe në tre Njësi Administrative me popullsinë më të madhe, NJA Bicaj, NJA Shishtavec, NJA Mal Zi.

**2.Fuqizimin e rolit të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve, Grupit teknik ndërsektorial** duke synuar që fëmijët në nevojë për mbrojtje të referohen pranë çdo shërbimi që ndihmon në mirëqenien e tyre fizike, psiko-emocionale, shëndetësore, arsimore, kulturore.

Roli i punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve është

- a. identifikimi i rasteve, përgatitja e planeve të ndërhyrjes në bashkëpunim me GTN-në dhe referimi pranë shërbimeve sipas nevojave të identifikuara.
- b. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.
- c. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:
- d. të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe të cilët kanë kontakt me fëmijët;
- e. të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- f. të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;
- g. të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;
- h. të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;
- i. të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes.
- j. të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;
- k. të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;
- l. të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planin individual të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxherrasti;
- m. t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.
- n. të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

**3.Emërimi në strukturën e Koordinatorit vendor për dhunën në familje** i cili do të jetë personi përgjegjës në koordinimin e punës së ekipit teknik ndërsektorial, i cili ngrihet dhe funksionon në bazë të Ligjit 47/2018 dhe VKM Nr. 327, datë 02.06.2021 si dhe asiston dhe referon viktimën e





KV-ja, njëherë në muaj, informacionin për të gjitha rastet e institucionit, për parësishmësi të ndërhijakës që në për bashkë të, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda institucionit të vet;

paraqitura apo të trajtuar nga

- m) Sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykatat për ndjekjen e hapave të duhura të shkeljeve të urdhrave të gjykatës, sidhë sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhijave të nevojshme në përputhje me ligjin;
- n) Asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM), sidhë për hapat që duhen ndjekur, nëse urdhri shkellet;
- o) Shoqëron viktimat dhe në gjykatë, policinë dhe/ose pranë shërbimeve të tjera;
- p) Harton planin për bashkë të ndërhijës (PPN), sikurse parashikohet në këtë vendim;
- q) Monitoron, gjatë kohës gjatë se vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektim i urdhrit të mbrojtjes ngapalët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë për gatit një raport, për të cilin në çdo rast, vënë dijeni Policinë e Shtetit;
- r) Bashkëpunon për të siguruar vizitat në banesë në viktimë sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm;
- s) Koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, sipas ligjit nr.47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin të jetë që punon me komunitetin;
- t) Mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave që fitojnë për të dhënë në familje dhe shërbime materiale ose botimet e ndryshme sensibilizuese të gjegjësuës për dhunën;
- u) Harton marrëveshjet bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të legjislativ në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, në përputhje me përparimet e marrëveshjes bashkëpunimit dhe i propozon ato komitetit dhe jtu për miratim në parim;
- v) Paraqet raportet e mëjore, të mëjore dhe jetore për parakomitetit të drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave për personat e viktimave;
- w) Identifikon protokollet e zistues në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme;
- x) Propozon krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat dhe në marrëdhëniet familjare në strukturë të shërbimeve sociale pranë njësive të qeverisjes vendore;
- y) Është anëtar i grupit që për gatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për mirësimin ose ngritjen e shërbimeve të japë subjektet e përshirand hënë në familje, sidhë anëtari i grupit që për gatit planet vendore për barazinë gjinore në nivel vendor

**4. Specialisti për strehimin social** është punonjësi i cili ka për detyrë të identifikojë familjet në nevojë për strehim, dhe duke i orientuar ata drejt programeve të ndryshme të strehimit sipas kërkesës dhe nevojave që paraqesin.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të ngrenë fondin publik për banesa sociale i cili

krijohet nga fonde të pushtetit vendor/qëndror si dhe nga subjektet private fitimprurëse/jo fitimprurëse dhe nga donator të ndryshëm.

Ai ka për detyrë :

- a. Identifikimin e individëve e familjeve në nevojë për strehim.
- b. Identifikimin e nevojave për strehim.
- c. Identifikimin e subjekteve private dhe donatorëve të ndryshëm të interesuar për të investuar në drejtim të strehimit social.
- d. Menaxhimin e regjistrit të strehimit dhe përditësimin e të dhënave sipas kërkesave.
- e. Publikimin e programeve të strehimit të cilat ka në dispozicion Bashkia.
- f. Përgatitjen e listave të përfituesve për programe të ndryshme strehimi dhe paraqitjen për miratim pranë Këshillit Bashkiak

**5. Administratori shoqëror dhe PAK në njësitë administrative** është specialisti i cili ofron ndihmë shoqërore dhe shërbime sociale, individëve me status të veçantë dhe familjeve në nevojë, Administratori shoqëror përgjigjet në lidhje me zbatimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve sociale ndaj individëve dhe grupeve në nevojë.

Administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë:

- a. të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'iftojnë në informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike;
- b. të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;
- c. të verifikojnë nëpërmjet vizitave në familjet dhe në terren gjendjen sociale-ekonomike për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe, dy herë në vit, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Verifikimi për familjet që aplikojnë për herë të parë kryhet brenda muajit të aplikimit. Të dhënat verifikuar nëpërmjet vizitave në familjet hidhen në Regjistrin Elektronik Kombëtar;
- d. të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;
- e. të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe masat e përfitimit, në bazë të vërtetimeve të vendimeve të komisioneve të vlerësimit dhe të dokumentacionit për përfitime të tjera shtesë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- f. të përcjellin dokumentacionin për vlerësimin e aftësisë së kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- g. të evidentojnë dhe të verifikojnë rastet e personave që përfitojnë në kundërshtim me germën a, të nenit 11, të këtij ligji, të kryejnë verifikime jo më pak se një herë në tre muaj, të informojnë strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur kanë detyrë;
- h. të ndërpresin pagesën e aftësisë së kufizuar për personat që përfitojnë në kundërshtim me germën a, të nenit 11, të këtij ligji, në bazë të verifikimit të kryer nga strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror në nivel rajonal;
- i. të administrojnë dokumentacionin për përfitimin e pagesave të personave me aftësi të kufizuar;
- j. të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e vetëqeverisjes vendore;

- k. të grumbullojnë e të hartojnë informacione dhe statistika për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuara dhe t'i raportojnë ato pranë bashkisë;
- l. të bashkërendojnë informacionin lidhur me familjet përfituese me administratorët e jetërë shoqërorë të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- m. të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me këmbimin e ndihmës ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuara, me anë të fushatave të ndryshme informuese;
- n. të bashkëpunojnë me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuara, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- o. të adresojnë rastet e individëve/familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore e të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore.

## 6. Shefi i Sektorit

Përgjigjet para drejtorit përkatës dhe kur i kërkohet drejtpërdrejt para Kryetarit të Bashkisë për shkallën e plotësimit të detyrave të ngarkuara nga ana e tij punonjësve që punojnë në sektor.

Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo zyrë e punonjës në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave të drejtorisë.

Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe shqetësimet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon drejtorit rrugëzgjdhjet përkatëse.

Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi, për plotësimin e detyrave që u janë ngarkuar.

Kryen studime për fusha të ndryshme dhe organizon sistemin e informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit që mbulon.

## 6.3. Shërbime të Kujdesit Shoqëror në qendrat komunitare, multifunkionale dhe të emergjencës

### Qendra komunitare për personat me aftësi të kufizuara

#### 1. Manaxheri i Qendrës

- Përgatit dhe plotëson planet e punës tre mujore dhe vjetore të Qendrës
- Mbikëqyrë stafin/ekipin multidisiplinar të Qendrës për zbatimin e aktivitetit të përditshëm të punës me fëmijët në Qendër dhe komunitetit.
- Organizon takime mujore, tremujore me stafin profesional për progresin e fëmijëve në përputhje me programet e tyre individuale të punës.
- Bashkëpunon dhe koordinon me stafin profesional në zhvillimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve.
- Koordinon trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në çështjet e aftësisë së kufizuara nga ana e stafit profesional.
- Koordinon me shkollat për të mbështetur aktivitetet ndërgjegjësuese me bazë komunitare për rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve dhe adoleshentëve me aftësi të kufizuara në shkollë dhe në jetën shoqërore.
- Merr përgjegjësi direkt për menaxhimin e buxhetit të qendrës, duke siguruar që: Shpenzimet janë

në përputhje me nevojat dhe planet e punës;

## **2. Punonjësi social**

Punonjësi social ka rolin e personit të kontaktit midis Qendrës dhe familjes së fëmijës dhe në raport me familjen detyra e tij është që të:

- Të vlerësojë situatën socio-ekonomike të familjes së fëmijës, gjeneroj informacion të detajuar mbi gjendjen socio-ekonomike të familjes, kushtet e tyre të jetesës dhe nivelin e mbështetjes që familja i jep fëmijës me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ai analizon marrëdhëniet që ekzistojnë brenda familjes,
- Të vlerësojë nëse të drejtat themelore të fëmijëve me aftësi të kufizuara respektohen plotësisht nga anëtarët e familjes dhe ai nuk përballet me asnjë akt të dhunshëm,
- të informojë familjen për dokumentacionin e nevojshëm që janë të nevojshme për dosjen e fëmijës,
- Të jetë në kontakt të rregullt me familjen në drejtim të këshillimit dhe mbështetjen e tyre për përmbushjen e programit të edukimit të fëmijës në familje.
- Të jetë në kontakt të rregullt me familjen në lidhje me ecurinë e fëmijës dhe problemet specifike që ai mund të shfaqë në familje,
- Të shoqërojë fëmijën në Institucion tjetër, në rast se kjo kërkohet nga ekipi multidisiplinar si pjesë e PEI.
- Punonjësi social është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe jep mendimin e tij gjatë vlerësimit
- Punonjësi social zbaton PEI e fëmijës, në grup apo individualisht, kryesisht në këto drejtime:
- Organizon lojëra, ekskursione, aktivitete kulturore dhe sociale, konkurse, gara sportive, aktivitetet ndërgjegjësuere në qendër dhe në komunitet.
- Punonjësi social është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së fëmijës
- Punonjësi social do të jetë përgjegjës për marrëdhënien me fëmijën që ndiqet në komunitet duke:
- Të ndjek dhe raportoj tek menaxheri realizimin e aktiviteteve sipas planit punës.

## **3. Psikologu, si pjesë e ekipit multidisiplinar dhe**

- Vlerëson gjendjen e fëmijëve me AK dhe ndërton PEI në fushat e zhvillimit të fëmijës dhe vendos objektivat për ndërhyrjen, problemeve psiko-emocionale, shkallës së zhvillimit të tyre,
- Informon dhe mbledh ekipin multidisiplinar, kur vjen koha për ri-vlerësimin e fëmijës, në bazë të rezultateve të arritura nga objektivat e vendosura në PEI e parë të fëmijës.
- Ofron terapi individuale të zhvillimit dhe sjelljes bazuar në PEI e fëmijës me qëllim të mbështetjes së fëmijës me nevoja të veçanta për të zvogëluar problemet e sjelljes (sjelljes agresive, episodeve të jashtë-kontrollit nga zemërimi, tolerancës së dobët apo zhgënjimin e tepruar dhe / ose sjelljet vetë-dëmtuse, balancimine sjelljeve të tilla si tërheqja sociale) dhe të nxis aftësitë e përshtatjes; problemet psiko-emocionale.
- Ofrimin e këshillimit psikologjik dhe mbështetjes për fëmijët:
- Ofron mbështetje në shtëpi, zhvillimin e fëmijës, strategji të sjelljes dhe motivim dhe aftësi të tjera bazë që lehtësojnë aftësinë e tyre për të mbështetur arsimimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre.
- Ndihmon dhe mbështet familjet për të kuptuar sfidat e fëmijëve të tyre dhe mëson prindërit / kujdestarët për aftësitë e nevojshme për të ndihmuar fëmijët e tyre të zhvillojnë aftësinë për të kryer detyrat e përditshme.

- Ofrimin e mbështetjes për familjen e fëmijës me aftësi të kufizuara :
- Mbajtjes së kontakteve me anëtarët e familjes së fëmijës dhe analizon marrëdhëniet e tyre me fëmijën me nevoja të veçanta,
- Analizon marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes dhe se si ato ndikojnë në fëmijën me nevoja të veçanta,
- Vlerëson gjendjen psiko-emocionale të ofrimit të përkujdesjes dhe se si ajo ndikon në zhvillimin e fëmijës dhe përmirësimin e tij/saj,
- Ndjek realizimin e programit të fëmijës brenda ambientit të kopshtit dhe shkollës duke mbështetur mësuesit në zbatimin e programit të fëmijës.
- Mbështet prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta në mënyrë që ata të ndihmojnë fëmijët e tyre për tu zhvilluar më mirë.
- Lehtëson dhe mbështet grupet mbështetëse të prindërve me qëllim për të siguruar pjesëmarrjen e prindërve në mënyrë që ata mund të ndajnë përvojat e tyre, ndjenjat, sfidat e të qenit prind, gjyshërit apo vëllezërit e motrat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe strategjitë e tyre të përballimit.
- Në bashkëpunim me stafin e qendrës koordinon dhe lehtëson aktivitetet ndërgjegjësuëse me fëmijët në komunitet.
- Ndjek dhe raporton tek menaxheri realizimin e aktivitetëve sipas planit punës.

#### 4. Terapist të folurit/Logoped:

Si pjesë e ekipit multidisiplinar, terapisti i të folurit Vlerëson nevojat e fëmijës në lidhje me gjuhën dhe komunikimin si më poshtë:

- Vëzhgon fëmijën dhe vlerësimin natyrën e çrregullimeve të komunikimit që ai përfaqëson,
- Vlerëson aftësinë e fëmijës për të komunikuar
- Vlerëson aftësinë për të kuptuar (verbal, 1,2 hapa, gjeste, fotot)
- Vlerëson problemet motorike që ndërhyjnë në vokalin e fëmijës
- Vlerëson mënyrën e shqiptimit
- Vlerëson gabimet sintaksore gjatë komunikimit
- Vlerëson aftësitë e gjuhës basale të fëmijës
- Vlerëson mënyrën se si fëmija kryen kërkesat, përsërit fjalët, dialogun, etj
- Vlerëson komunikimin sociale dhe komunikimin jo-funksionale (ekolalia)
- Vlerëson aftësinë e fëmijës për të imituar.
- Përgatit Planin e Komunikimit për ndërhyrjen si pjesë e PEI të fëmijës në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar dhe zbaton atë në këto fusha:
  - Në kushtet e shqiptimit dhe korrigjimin e fonemave, me zë dhe me regjistrimet
  - Trajnon fëmijën të përdorë kërkesat, komandat intërabverbale, etj.
  - Trajnon fëmijën të kuptojë (emërtimin e objekteve, pjesëve të trupit, tiparet, etj)
  - Trajnon fëmijën për të imituar, dhe të përdorin gjestë për të komunikuar,
  - Trajnon fëmijën për të përdorur PECS (Sistemin e komunikimit nëpërmjet ndryshimit të figurave).
- Kombinon trajnimin për komunikim me seancat e tjera të terapisë së zhvillimit, etj
- Përcakton natyrën e ndërhyrjes dhe nr. e seancave të të folurit (në mënyrë individuale dhe në grup) që fëmija ka nevojë për të ndjekur në qendër.
- Të ketë njohuri mbi përdorimin e teknologjisë ndihmëse dhe të formave të tjera të komunikimit që lehtëson komunikimin e fëmijëve me çrregullime të të folurit.
- Të mbështeti mësuesit e shkollës ku fëmija mëson gjatë zbatimit të PEI.

- Bashkëpunon dhe këshillon familjen mbi teknikat që ata mund të përdorin për të ndihmuar fëmijën për të komunikuar.
- Të jetë në gjendje të ofrojë terapi të foluri për fëmijët në kushte shtëpie.
- Ndjek dhe raporton tek manaxheri realizimin e aktiviteteve sipas planit punës.

#### 5. **Terapisti okupacional**

- Bashkëpunon dhe koordinon punën e tij brenda ekipit multidisiplinar.
- Ai është pjesë e vlerësimit të fëmijës dhe vendosjen e objektivave në lidhje me pjesën profesionale gjatë hartimit të PEI së fëmijës.
- Bashkëpunon dhe mbështet anëtarët e ekipit multidisiplinar gjatë terapisë së tyre individuale dhe në grup për zhvillimin e fëmijës.
- Ai është në kontakt të shpeshtë me familjen e fëmijës me aftësi të kufizuara duke pasur një pasqyrë të detajuar të:
  - Aktivitetit të fëmijës dhe si funksionon ai në kushtet e shtëpisë,
  - Si fëmija kalon kohën e tij të lirë dhe cilat janë preferencat e tij,
  - Në konsultim me fizioterapistin, vëzhgon veprimtarinë e fëmijës nëse ai ka nevojë për mbështetjen e pajisjeve lëvizëse gjatë kryerjes së rutinës së tij.
- Bashkëpunon me psikologun dhe punonjësin social në realizimin e trajnimeve të ndryshme të përshtatura për aftësitë, tendencat dhe preferencat e fëmijës me aftësi të kufizuara për të kryer detyra të thjeshta me pak mbështetje.
- Trajnon fëmijën me aftësi të kufizuara për ti shërbyer vetës në mënyrë të pavarur, të ushqehet, shkoj ne tualet, të pastroj, të veshet, etj.
- Trajnon fëmijën me aftësi të kufizuara për të kryer detyra të ndryshme në qendër dhe në shtëpi duke filluar nga më të thjeshtat deri tek ato detyra që kanë nevojë për mbështetje, në kuzhinë, gatim, mirëmbajtjen e mjedisit, etj
- Punon në mënyrë të vazhdueshme të rrisë vetëbesimin e personit me aftësi të kufizuara, duke mbështetur dhe duke forcuar atë në mënyra të ndryshme.
- Organizon seancat okupacionale/profesionale (individuale, grupi, terpinë e lojës, terapi arti, terapi drama): Brenda strukturës së ekipit multidisiplinar, trapisti profesional do të sigurojë seanca individuale dhe grupi (artin e lojës dhe dramës), që do të mbahet çdo javë me fëmijët, me qëllim tu jap atyre mundësinë për të shqyrtuar rolin e tyre, idetë dhe ndjenjat rreth vetës dhe të tjerëve me anë të teknikave të lojës dhe të artit.

#### 6. **Fizioterapisti**, si pjesë e ekipit multidisiplinar, vlerëson gjendjen e fëmijëve me AK fizike, në drejtim të:

- Vlerësimit të problemeve të deformimit gjymtyrëve, kolonës dhe nivelin e deformimit,
- Vlerëson tonin e muskujve,
- Vlerëson aftësinë për tu shtrirë, qëndrimin ulur, dhe ngjitjen, lëvizur, ecur, vrapuar, ngjitur shkallët, mbajtur balancën, etj.
- Aftësisë së koordinimit sy-dorë, dëgjim-lëvizje, etj.
- Aftësi për të mbajtur ritmin.
- Organizon punën me fëmijën në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të ekipit multidisiplinar.
- Plotëson raportin e nevojave fizike të fëmijës dhe vendos objektivat për fushën e psikomotricitetit si pjesë e PEI së fëmijës dhe idiskuton objektivat me ekipin multidisiplinar.

- Harton objektiva të qarta hap pas hapi për të përmirësuar aftësitë e motorikës fine dhe globale të fëmijës, koordinimin, uljes e spazmave, qëndrimin në pozicion korrekt, etj.
- Harton programin ditor të fëmijës, mjetet që duhen përdorur nga secili fëmijë, bazuar në planin e punës, si dhe vendin se ku do të ndiqet terapia, kjo në bashkëpunim edhe me prindin.
- Ofron seanca fizioterapie individuale për fëmijën sipas një grafiku dhe programit të aprovuar nga ekipi multidisciplinar.
- Përdor teknika motivimi gjatë punës së tij me fëmijën kur ai refuzon të bashkëpunoj gjatë ushtrimeve. Kombinon lojën me terapinë për ti dhënë mundësi fëmijës ta shijoj terapinë.
- Ofron këshilla të vazhdueshme për familjen për tu ndjekur në shtëpi në lidhje me: përdorimin e mjeteve ndihmëse, pozicionin e trupit, qëndrimin në karrige, në krevat, ngjitje/zbritje shkalle, qëndrimin në tualet, etj.
- Instrukton kujdestarin e fëmijës me teknika të thjeshta dhe të kënaqshme për fëmijën të cilat mund të aplikohen me fëmijën në shtëpi gjatë aktivitetit të tij ditor.
- Koordinohet me instruktorët (në shkollën apo kopshtin) që fëmija ndjek për tu treguar atyre pozicionin dhe zakonet që fëmija duhet të ketë në klasë.
- Mbështet fëmijës me çrregullime të spektrit autik për të ndjekur programin në qendër dhe familje në fushat si më poshtë:
- Aplikimin e masazheve të shkurtra të trupit për fëmijët me problem sensoriale bazuar në objektivat e programit individual.
- Aplikimin me ushtrime okupacionale dhe në topin e fitmesit për fëmijët me problem proprioceptive dhe balancës.
- Aplikimin e sesioneve të shkurtra të ushtrimeve që ndihmojnë çlirimin e energjive tek fëmijët me probleme në sjellje, hipëraktivitet.
- Informimin e prindërve për aplikimin e këtyre teknikave në ambientin e shtëpisë.
- Të zbatoj kodin etik në punën me fëmijët me AK, përdor fjalorin e duhur, të tregojnë kujdes gjatë aplikimit të ushtrimeve për të krijuar një marrëdhënie të drejtë bashkëpunimi me fëmijën.
- Në bashkëpunim me stafin e qendrës koordinon dhe lehtëson aktivitetet ndërgjegjësuere me fëmijët në komunitet.

## 7. Edukatori

- Bashkëpunon dhe koordinon punën e tij brenda ekipit multidisciplinar. Ai është pjesë e vlerësimit të fëmijës dhe vendosjen e objektivave në lidhje me pjesën e profesionale gjatë hartimit të PEI së fëmijës.
- Bashkëpunon dhe mbështet anëtarët e ekipit multidisciplinar gjatë terapisë së tyre individuale dhe në grup për zhvillimin e fëmijës.
- Ai/Ajo është i ngarkuar për zbatimin e programit të psiko edukimit të fëmijëve me probleme të zhvillimit në një grup me 5-6 deri në 10 fëmijë.
- Siguron zbatimin e PEI për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara brenda grupit dhe mbështet fëmijët për të mësuar rregullat për të vepruar në grup.
- Kombinon programin njohës të fëmijës me lojërat dhe aktivitetet e përshtatshme për moshën dhe nivelin e zhvillimit të tij. (Konceptet përceptive, përformance njohëse, konceptet e numrit, lapsin dhe simbolet, etj)
- Ndihmon socializmin e fëmijëve me njëri-tjetrin Brenda në grup, duke krijuar marrëdhënie, respekt dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin, se si të luajë në grup, parandalimin

- dhe shmangien e situatave konfliktuale, etj
  - Në bashkëpunim me psikologun, ndihmon për të menaxhuar sjelljen e papranueshme të fëmijëve duke e mbrojtur atë për të mos dëmtuar vetën dhe fëmijët e tjerë në grup.
  - Përdor përforcuesit dhe teknikat pozitive që të përmirësojë sjelljen e fëmijës.
  - Në bashkëpunim me logopedin, ndihmon fëmijën për të përmirësuar komunikimin në grup duke përdorur teknika për të promovuar sa më shumë komunikim koherent
- promovimin e komunikimit funksional për fëmijët që kanë probleme

- Ndihmon aktivitetin fizik të fëmijëve në grup, të tilla si: aftësitë e motorikës fine dhe globale, koordinimin sy-dorë, që kryejnë lojëra për të promovuar ekuilibrin dhe aftësitë motorike.
- Në bashkëpunim me terapistin okupacional, trajnon fëmijën me aftësi të kufizuara për të shërbyer vetë në mënyrë të pavarur, të ushqehet, tualetin, pastrimin, veshje-zhveshje, etj
- Asiston dhe observon problemet e ndryshme të sjelljes së fëmijës gjatë rutinës së përditshme në kuzhinë, nevojat personale, dhe informon specialistët.
- Pasuron dhe plotëson dosjen e fëmijës me veprat kreative që ai ka bërë në tavoline (vizatime, etj)
- Mbështet fëmijën për problemet shëndetësore që ai mund të paraqes gjatë ditës dhe informon Menaxherin.
- Forcon aftësitë akademike të fëmijëve që ndjekin programin në shkolla.
- Mban kontakt të vazhdueshëm me mësuesin mbështetës në shkolla dhe mbështet atë për të zgjidhur problemet me të cilat ai ndeshet gjatë zbatimit të PEI me fëmijën në klasë.
- Në bashkëpunim me terapistin okupacional, organizon seancat profesionale dhe aktivitetët artistike në grup, terapi loje, terapi arti, terapi drame, aktivitete jashtë qendrës, aktivitete të avokimit, etj
- Ndjek dhe raporton tek Supervizori realizimin e aktiviteteve sipas planit të punës.

### **Punonjësit në strehëzën e emergjencës 48 orëshe për viktimat e dhunës**

Shërbimi i emergjencës ofrohet për individë viktimë të dhunës në familje nga zonat rurale, që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.

Ky shërbim duhet të menaxhohet nga sektori i shërbimeve sociale në Bashki i cili në bashkëpunim me punonjësit e policisë, koordinatorin vendor për dhunën, në bazë të rrezikshmërisë që paraqet rasti, mund të strehohet për njëperiudhë 48 orëshe .

Stafi shërbimeve në këtë qendër ofron asistencë të rastit gjatë kohës së qëndrimit në qendër, mbështetje psiko-sociale dhe në bashkëpunim me koordinatorin vendor për dhunën referon rastin pranë shërbimeve të tjera të specializuara.



## 7. FUSHAT E VEPRIMIT TË PLANIT SOCIAL

### FUSHA 1: STRUKTURAT DHE BURIMET NJERZORE

**Qëllimi 1.** Fuqizimi i strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale

**Objektivi 1.** Ngritja e Njësive të vlerësimit të nevojave dhe e referimit të rasteve (NVR) në të paktën 4 NJA

**Aktivitetet:**

Krijimi i strukturës së NVR për 4 NJA sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime;

Miratimi i përshkrimeve të punës të figurave profesionale që do të përbëjnë NVR;

Hartimi i protokolleve të funksionimit të NVR.

**Aktorët përgjegjës:** Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative

**Objektivi 1.2:** Të fuqizohen strukturat e mbrojtjes sociale në Bashkinë Kukës dhe NJA

**Aktivitetet:**

Rritja e numrit të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve në bazë të nr të fëmijëve (1 punonjës për 3000 fëmijë) ;

Fuqizimi i rolit të administratorëve shoqërorë si pjesë e NJVNR;

Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (jurist + Ekonomist);

Emërtimi në strukturën e Bashkisë i punonjësve të barazisë gjinore, koordinatorit vendor për dhunën dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve .

**Aktorët përgjegjës:** DSHS, NJA, Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare

**Objektivi 1.3:** Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të SHS në bashki dhe NJA

**Aktivitetet:**

Trajnime mbi funksionimin e NVR;

Trajnime mbi zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social;

Trajnime të certifikuara në vazhdimësi në vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe grupeve vulnerabël;

Trajnime për planifikimin dhe monitorimi i shërbimeve sociale;

Trajnime për njohjen dhe përditësimin me ndryshimet ligjore, rregulloret e reja dhe procedurat;

Trajnime mbi dhunën në familje dhe trafikimi i qenieve njerëzore;

Trajnime mbi menaxhimin e rasteve (Identifikimi dhe referimi);

Trajnime mbi çështjet e shëndetit mendor;

Trajnime për ofrimin e shërbimeve të bazuara në qasjen multidisiplinare;

Trajnime për ofrimin e shërbimeve në banesë për të moshuarit dhe PAK;

Trajnime për ofrimin e shërbimeve në qendrat e emergjencës për të mbijetuarit e DHF dhe DHBGJ, fëmijët në situatë rruge;

Trajnime për ofrimin e shërbimeve të integruara për familjen;

Ofrimi i supervizimit të vazhdueshëm për stafin e NJA-ve dhe shërbimeve të ofruara nga Bashkia;

Aktivitete për rritje profesionale (vizita studimore, shkëmbime eksperiencash, pjesëmarrje në konferenca shkencore, etj.);

**Aktorët përgjegjës:** DSHS, MSHMS, Qendrat e akreditimit, NJA, OJF

**Objektivi 1.4** Të përmirësohen kushtet e punës dhe logjistika e strukturave të shërbimit social në Bashki dhe NJA

***Aktivitetet:***

Sigurimi i ambienteve, kushteve fizike të përshtatshme për punë në DSHS në Bashki dhe NJA;

Sigurimi i mjeteve të punës;

Sigurimi i transportit të përshtatshëm për stafin e SHS në Bashki dhe NJA.

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, NJA

**FUSHA 2: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË E KUKËSIT**

**Qëllimi 2.** Përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Kukësit

**Objekti 2.1:** Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

***Aktivitetet:***

Ngritja e qendrave të reja komunitare në tre NJA (Bicaj, Shtiqën, Shishtavec);

Ngritja e shërbimeve të mbështetjes psiko -emocionale për fëmijët e abuzuar;

Ngritja e shërbimit të Kujdestarisë Alternative;

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, NJA, OJF

**Objekti 2.2:** Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare.

***Aktivitetet:***

Ngritja e një programi informimi dhe ndërmjetësimi për punësimin e grave;

Krijimi i mekanizmave lehtësues për përfitimin nga programet e strehimit;

Ofrimi i shërbimeve ligjore falas për gratë kryefamiljare dhe të mbijetuara nga DHF dhe trafikimi;

Ngritja e programit për nxitjen e sipërmarrjes private të grave;

Ofrimi i bonusit të qerasë për gratë vitkima të dhunës e trafikimit.

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, OJF, Biznesi

**Objekti 2.3:** Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë.

***Aktivitetet:***

Riorganizimi i qendrës ditore për të moshuarit duke ofruar një vakt ushqimi

Ngritja e qendrave ditore për moshën e tretë në zonat rurale (NJA Bicaj, NJA Shishtavec)

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit e vetmuar;

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, NJA, OJF, DRSHSSH

**Objekti 2.4** Të ngrihen programe fuqizuese dhe shërbime për personat me AK.

***Aktivitetet:***

Vlerësimi i nevojave për shërbime për PAK;

Ngritja e një shërbimi lëvizës për PAK në banesë;

Krijimi i një qendre komunitare publike për shëndetin mendor sipas modelit multidisiplinar të shërbimeve për PAK

Hartimi i projekteve për ngritjen e modelit shtëpi familje për PAK mbi moshën 21 vjeç

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, DRSHSSH, AKP, NJA, OJF

**Objekti 2.5** Të krijohen shërbime multifunksionale për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

***Aktivitetet:***

Ofrimi i programeve fuqizuese profesionale;

Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian;

Krijimi i mekanizmave lehtësuese për përfitimin nga programet e strehimit

***Aktorët përgjegjës:*** DSHS, DRFP, NJA, AKP, OJF

**Objekti 2.6:** Të fuqizohen shërbimet për të mbijetuarit e DHF dhe DHBGJ

Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes psiko-sociale për të mbijetuarit e DHF dhe trafikimit;  
Ofrimi i asistencës ligjore falas;  
Kalimi i qendrës së emergjencës për rastet e DHF dhe DHBGJ nën juridiksionin e Bashkisë  
Programe për fuqizimin ekonomik të mbijetuarve të DHF dhe trafikimit;  
**Aktorët përgjegjës:** DSHS, MMRS, NJA, OJF

**Objektivi 2.7:** Të krijohen shërbime fuqizuese për të rinjtë.

**Aktivitetet:**

Ngritja e një Qendre Rinore multifunkionale në qytetin e Kukësit;  
Krijimi i programit për nxitjen e punësimit të të rinjve në Bashki;  
Nxitja e vullnetarizmit tek të rinjtë në mbështetje të grupeve vunerabël  
**Aktorët përgjegjës:** DSHS, MAS, MR, NJA, OJF

### **FUSHA 3: ZBUTJA E VARFËRISË**

**Qëllimi 3:** Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë në Bashkinë e Kukësit

**Objektivi 3.1:** Të sigurohet mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë

**Aktivitetet:**

Identifikimi i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE;  
Miratimi i kriterëve për përzgjedhjen e familjeve që do të përfitojnë nga 6% dhe fondet e Bashkisë;  
Punësimi përmes programit të riintegritit social për kategoritë në nevojë (familjet përfituese të NE, gratë kryefamiljare dhe të rinjtë);  
Ofrimi i mbështetjes emergjente për nevojat bazë materiale të familjeve në nevojë;  
Krijimi i mekanizmave për përfitimin e bonuseve dhe produkteve me çmime të ulta, (marrëveshje Bashki-Biznes);  
**Aktorët përgjegjës:** DSHS, NJA, OJF

### **FUSHA 4: PROGRAMET PARANDALUESE**

**Qëllimi 4:** Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese

**Objektivi 4.1:** Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara

Programe edukuese për varësinë nga substancat me të rinjtë në shkolla;

Programe këshillimi paramartesor/për çiftet e reja;

Integrimi i programeve të edukimit të prindërve në shërbimet komunitare egzistuese;

Program ndërgjegjësues për DHF dhe DHBGJ;

Program ndërgjegjësues /edukues për parandalimin e martesave të hershme në komunitetin Rom dhe Egjiptian;

Program sensibilizues kundër diskriminimit;

**Aktorët përgjegjës:** DSHS, MSHMS, MSH, NJA, OJF, DRSH, DAR

**Objektive 4.2:** Të rritet ndërgjegjësimi publik për problemet sociale që shqetësojnë komunitetin e Kukësit

**Aktivitetet:**

Programe sensibilizuese në Mediat lokale;

Aktivitete kulturore mbi çështje sociale;

Aktivitete sportive sensibilizuese;

Aktivitete për ngritje fondesh për të adresuar çështje sociale;

**Aktorët përgjegjës:** DSHS, MSHMS, DAR, NJA, OJF, Biznesi

**Objektivi 4.3:** Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet

egzistuese

***Aktivitetet:***

Krijimi i programeve edukuese për fuqizimin e familjes (aftësi të prindërimit, menaxhim i të ardhurave/burimeve, konflikteve);

*Aktorët përgjegjës:* DSHS, NJA, OJF

**FUSHA 5: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE**

**Qëllimi 5:** Forcimi i strukturave koordinuese dhe monitoruese të shërbimeve sociale

**Objektivi 5.1:** Të fuqizohen strukturat koordinuese në Bashki dhe NJA

***Aktivitetet:***

Forcimi i mekanizmave për adresimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve;

Vënia në funksionim e MR për fëmijët;

Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor;

Emërimi i koordinatorit vendor për dhunën në Bashki

*Aktorët përgjegjës:* DSHS, NJA, OJF, DAR, Policia, Gjykata, Mjekësia ligjore

**Objektive 5.2** Të krijohen formate të standartizuara për menaxhimin e rasteve, monitorimin dhe raportimin.

***Aktivitetet:***

Hartimi dhe miratimi i formateve standarte: të vlerësimit të nevojave të komunitetit dhe vlerësimit për menaxhimin të rasteve;

Ndërtimi dhe miratimi i një baze të dhënash për popullatën, kategoritë në nevojë, shërbimet dhe programet e disponueshme në territor, përfituesit e shërbimeve;

Forcimi i kapaciteteve për mbledhje të dhënash, monitoruese dhe raportuese të stafëve;

*Aktorët përgjegjës:* DSHS, MSHMS, SHSSH, NJA, OJF

## 8. MATRICA E PLANIT SOCIAL PËR BASHKINË E KUKËS

### Qëllimi 1: Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë

Objektivi 1.1: Rritja e mbështetjes për familjet e varfëra dhe ekstremisht të varfëra për të ndryshuar situatën e tyre social-ekonomike

Rezultati/ Produkti	Aktivitete
1.1.1 Transparencë nga sistemi i Ndhmës Ekonomike për mënyrën e përfitimit të kësaj ndihme.	1.1.1.1 Asistencë e rritur nga pushteti vendor për të gjitha familjet që aplikojnë për skemën e ndihmës ekonomike.
1.1.2 Intergrim i këtyre familjeve në skemat e punësimit	1.1.2.1 Takime me familjet që janë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike për problemet që ata hasin për tu integruar në punë.
1.1.3 Ulje e numrit të familjeve që janë përfituese nga skema e Ndhmës Ekonomike	1.1.3.1 Bashkëpunim me bizneset për mundësi punësimi, nëpërmjet trajnimeve. 1.1.3.2 Asistencë për plotësimin e saktë të të dhënave për personat që aplikojnë për të përfituar ndihmën ekonomike.

Objektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve shtetërore që të adresojnë shërbimet sociale në varësi të nevojave që kanë popullata.

Rezultati/ Produkti	Aktivitete
1.2.1 Minimizimi i problemeve për familjet në nevojë.	1.2.1.1 Ngritja e grupeve multidisiplinare që bëjnë vlerësimin e situatave familjare në çdo njësi administrative.
1.2.2 Paraqitja e nje harte më të qartë për situatat me të cilat përballen familjet në nevojë.	1.2.2.1 Vlerësimi periodik mbi ecurinë e ndryshimeve për familjet në nevojë.
1.2.3 Rritja e mundësive për të ndryshuar situatën në bashkëpunim me OJF dhe institucionet shtetërore.	1.2.3.1 Takime me familjet për shqetësimet që ata kanë në jetën e tyre të përditshme. 1.2.3.2 Monitorim nga pushteti vendor mbi ecurinë e shërbimeve në plotësimin e nevojave të popullatës 1.2.3.3 Ngritje e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, nëpërmjet trajnimit.

Objektivi 1.3: Të rritet transparenca në mënyrën e menaxhimit të të ardhurave dhe fondeve të bashkisë për zhvillimin ekonomik dhe social.

Rezultati/ Produkti	Aktivitete
---------------------	------------

1.3.1 Rritja e përfitimeve të drejta, për grupet që në nevojë. 1.3.2 Përmirësim të situatës social-ekonomike të bashkisë.	1.3.1.1 Monitorim nga organe të posaçme të bashkisë/ qeverisë/ shoqëria civile për të reduktuar numrin e abuzimeve. 1.3.1.2 Informim më intensiv i komunitetit mbi vendimmarrjen 1.3.3.1 Përdorimi i fondeve në favor të zhvillimit ekonomik dhe social, duke plotësuar nevojat emergjente të komunitetit.
--	--

Objektivi 1.4: Të rritet bashkëpunimi me OJF-të që veprojnë në Kukës apo edhe organizata që veprojnë jashtë.

Rezultati/ Produkti	Aktivitete
1.5.1 Rritje e numrit të familjeve që përfitojnë shërbime nga OJF-të si: trajnime, këshillime, ushqime, strehim, arsimin, veshmbathje etj. 1.5.2 Rritje e numrit të projekteve nga OJF-të në dobi të grupeve në nevojë. 1.5.3 Shtrirje të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative dhe përmisim i cilësisë së shërbimeve.	1.5.1.1 Prezantimi i gjendjes së familjeve të varfra dhe problemet që ato hasin.  1.5.2.1 Koordinim mes organe shtetërore të pushtetit vendor dhe OJF-të  1.5.3.1 Mbështetje e organizatave për t'u lidhur me komunitetin dhe për të dhënë kontributin e tyre.

**Qëllimi 2: Përmisimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuar.**

Objektivi 2.1: Rritja e aksesit ndaj shërbimeve sociale dhe shëndetësore si dhe lobimi për plotësimin e nevojave bazë të personave me aftësi të kufizuar për një jetë dinjitoze.

Rezultati/ Produkti	Aktivitete
2.1.1 Paraqitje më e qartë e situatës në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuar për një ndërhyrje më efikase. 2.1.2 Mbështetja e mekanizmave të cilat punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. 2.1.3 Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese për personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre në komunitet dhe në skemat e punësimit. 2.1.4 Ofrimi i shërbimeve që këta persona të jenë më të përfshirë në shoqëri.	2.1.1.1 Sesione ndërgjegjësuese për njohjen me kushtet e jetesës dhe nevojat që paraqesin grupe të ndryshme të personave me aftësi të kufizuar. 2.1.2.1 Organizimeve i trajnimeve për stafet e pushteti vendor për mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar 2.1.3.1 Sesione ndërgjegjësuese për specialistët mbi zbatimin e kuadrit ligjor që ndalon diskriminimin për shkak të paaftësisë. 2.1.4.1 Realizimi i takimeve për ofrimin e asistencës sociale dhe shëndetësore pranë familjeve që kanë persona me aftësi të kufizuar. 2.1.5.1 Trajnimi i punonjësve social dhe shëndetësor mbi mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar.

<p>2.1. 5 Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave që janë në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.1.6 Nxitja për heqjen e pengesave në ndërtim në mënyrë që të lehtësohet lëvizja në ndërtesa, hapësira publike dhe në sistemet e transportit.</p>	<p>2.1.6.1 Vlerësime dhe vëzhgime për të identifikuar pengesat që hasin personat me aftësi të kufizuar.</p>
<p>Objektivi 2.2: Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes së regjistrimit elektronik për të shmangur sa më shumë rastet e abuzimit.</p>	
<p>Rezultati/ Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>2.2.1 Zbatimi i parimit të drejtësisë ku përfitojnë nga skema e paaftësisë personat që janë vërtetë në një situatë të tillë.</p> <p>2.2.2 Përmirësimi i shërbimit të kontrollit dhe të auditit për të ulur numrin e rasteve të abuzimit.</p> <p>2.2.3 Ulje e rasteve të abuzimit nga raportimet që bëhen nga komuniteti.</p> <p>2.2.4 Transparencë mbi mënyrën se si përdoren fondet që alokohen për pak.</p> <p>2.2.5 Rritje e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në vlerësimin e paaftësisë.</p> <p>2.2.6 Rritja e pagesës së personave me aftësi të kufizuar nga një përzgjedhje e drejtë.</p> <p>2.2.7 Personat e vlerësuar duhet të kenë të drejtën të njihen me dokumentacionin e vlerësimit të tyre</p>	<p>2.2.1.1 Ngritja e grupeve multidisiplinare që bëjnë vlerësimin e saktë dhe transparent mbi paaftësinë në çdo njësi administrative.</p> <p>2.2.2.1 Ofrimi i trajnimeve për stafin që do të monitorojë skemën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar, shtimi i hapësirave të punësimit</p> <p>2.2.3.1 Sesione ndërgjegjësimi për komunitetin për të raportuar rastet e abuzimit.</p> <p>2.2.4.1 Të bëhen publike të gjitha fondet që vijnë në shërbim të personave me aftësi të kufizuar dhe mënyra e menaxhimit të tyre</p> <p>2.2.5.1 Zhvillim trajnimesh për rritje të kualifikimit profesional për aktorët e përfshirë në skemën e paaftësisë</p> <p>2.2.6.1 Takime me MMSR për të parë mundësitë për rritjen e pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe verifikim mbi përfituesit e skemës së paaftësisë.</p> <p>2.2.7.1 Sesione informimi për të raportuar rastet e padrejtësive si nga komunitetin ashtu edhe nga vetë personat me aftësi të kufizuar.</p>
<p>Objektivi 2.3: Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet sociale me shërbimet e punësimit për një zhvillim social-ekonomik për personat me aftësi të kufizuar.</p>	
<p>Rezultati/ Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>2.3.1 Sisteme integrimi nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.</p> <p>2.3.2 Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar duke krijuar mundësi për një jetë të pavarur.</p>	<p>2.3.1.1 Krijimi i një databaze me të dhënat mbi shkollimin apo formimin profesional të personave me aftësi të kufizuar në zyrat e punësimit.</p> <p>2.3.2.1 Koordinimi i punës ndërmjet institucioneve, OJF-ve dhe bizneseve për të arritur zbatueshmërinë e ligjeve ekzistuese.</p>

<p>2.3.3 Përmirësimi i situatës social-ekonomike te personave me aftësi të kufizuar</p> <p>2.3.4 Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore dhe zvogëlimi i paragjykimi mbi personat me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.3.5 Ofrimi i shërbimeve te integruara ne nivel vendor për rehabilitimin apo riaftësimin në punë te PAK në bashkëpunim me OJF-të.</p>	<p>2.3.3.1 Lehtësira në taksa për bizneset që punësojnë personat me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.3.4.1 Takime me bizneset për të parë mundësitë e integritit në punë të personave me aftësi të kufizuar</p> <p>2.3.5.1 Përcaktimi me vendim Këshilli Bashkiak te detyrimit të mbledhjes se tavolinave multidisiplinare.</p> <p>2.3.5.2 Mbledhja e tavolinës multidisiplinare për personat me aftësi të kufizuar, 3-4 here në vit.</p>
<p>Objektivi 2.4: Sigurimi i mundësive të arsimimit gjithëpërfshirëse ku të jenë pjesëmarrës personat me aftësi të kufizuar</p>	
<p>Rezultati/ Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>2.4.1 Ofrimi i mundësive për t'u arsimuar bën që personat me aftësi të kufizuar të hedhin një bazë të fort për veten e tyre dhe në të ardhmen të shërbejnë edhe si specialist në sektorët e tyre.</p> <p>2.4.2 Rritja e kapaciteteve profesionale që mësuesit dhe edukatorët e tjerë të kuptojnë nevojat e mësimit nga studentët me aftësi të kufizuar</p> <p>2.4.3 Krijimi i ambienteve të shkollave të përshtatshme dhe gjithë përfshirëse që plotësojnë nevojat për arsimin e personave me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.4.4 Ngritja e mekanizmave që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për shkollë për arsye të aftësisë së kufizuar</p> <p>2.4.5 Fuqizimi i kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuar si pjesë e vendimmarrjes në jetën shoqërore.</p>	<p>2.4.1.1 Sesione trajnimi edukues dhe informuese për personat me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.4.2.2 Informime dhe trajnime të stafëve të shkollave për mënyrën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar, verifikim periodik nga specialistët mbi trajtimin e personave me aftësi të kufizuar në ambientet e shkollave apo kopshteve.</p> <p>2.4.3.1 Ndërgjegjësim në komunitetet e shkollave dhe komunitetet shoqërore për mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.4.4.1 Lobim për përgatitjen e lëndëve mësimore të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.</p> <p>2.4.5.1 Organizimi i takime me tavolina multidisiplinare ku të jenë pjesëmarrës edhe personat me aftësi të kufizuar, përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në mbledhjet e këshillave bashkiakë.</p>
<p>Objektivi 2.5 Zbatimi i kuadrit ligjor për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.</p>	
<p>Rezultati/ Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>



<p>2.5.1 Zbatueshmëria e ligjit nga ana e stafit për një shoqëri më të drejtë për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.5.2 Respektimi i të drejtës së informimit dhe të drejtës së pjesëmarrjes në vendimet që merren nga pushteti vendor.</p>	<p>2.5.1.1 Ofrimi i trajnimeve dhe informimi për stafet përgjegjëse të pushtetit vendor për të rritur kapacitetet e tyre profesionale në shërbim të personave me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.5.2.1 Seanca informuese me personat me aftësi të kufizuara për të njohur më shumë të drejtat e tyre dhe për të raportuar për rastet e shkeljeve, të përfshihen e pikëpamjet e personave me aftësi të kufizuara për një vendimmarrje më të drejtë</p> <p>2.5.2.2 Krijimi i infrastrukturës e sinjalistikës së nevojshme për eliminimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara.</p>
<p>Objektivi 2.6: Reformimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuara</p>	
<p>Rezultati/ Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>2.6.1 Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje.</p> <p>2.6.2 Vlerësimi dhe referimi nga punonjësi social i njësisë vendore mbi ecurinë e funksionimit të skemës së paaftësisë</p> <p>2.6.3 Mosdiskriminimi dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë në shoqëri.</p> <p>2.6.4 Rritja e kapaciteteve të stafit të shërbimit social për menaxhimin e skemës së vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.6.5 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të shprehur mendimet e tyre</p> <p>2.6.6 Krijimi një sistemi të përshtatshëm për metodat e komunikimit dhe informacionit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.6.7 Ulja e numrit të personave që përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga skema e paaftësisë dhe rritje e përfitimeve për personat që janë me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.6.8 Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve për</p>	<p>2.6.1.1 Informim dhe këshillim bazë për të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informimi edhe për përfitimet cash.</p> <p>2.6.2.1 10Rraportime tremujore të performancës së skemës së paaftësisë për politik-bërësit dhe për vlerësimin e profilit të riskut nga ana e punonjësit social të njësisë.</p> <p>2.6.3.1 -Realizimi i takimeve periodike mujore me stafet përgjegjëse të pushtetit vendor dhe organizatat e shoqërisë civile për raportime mbi respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.</p> <p>2.6.4.1 Trajnimi i personave përgjegjës për mënyrën e aplikimit të personave me aftësi të kufizuara në skemën e paaftësisë.</p> <p>2.6.5.1 Sesione dëgjuese për të marrë mendimet që kanë personat me aftësi të kufizuara për mënyrën e re të vlerësimit të paaftësisë.</p> <p>2.6.6.1 Trajnime për stafin për mënyrën e komunikimit me personat me aftësi të kufizuara për të marrë dhe për të dhënë informacion.</p> <p>2.6.7.1 Sesione ndërgjegjësimi për komunitetin e bashkisë dhe të njësisë vendore si dhe për personat me aftësi të kufizuara për të raportuar abuzimet e mundshme.</p> <p>2.6.8.1 Kontrolle periodike mujore nga specialistë për të bërë monitorim e funksionimit të skemës së re të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara.</p>

<p>personat me aftësi të kufizuar në nivel vendor</p> <p>2.6.9 Sensibilizimin e personave të vlerësuar lidhur me legjislacionin në fuqi dhe të drejtat e tyre.</p>	<p>2.6.9.1 Sesione informuese me personat me aftësi të kufizuar për të njohur me legjislacionin në fuqi.</p>
--	--

### Qëllimi 3: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social për Fëmijët, të Rinjtë, Gratë, Moshën e tretë, Komunitetin Rom dhe Egjiptian

Objektivi 3. 1 Rritja e mbështetjes për qendrat të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit social për ngritjen e një sistemi të integruar shërbimesh në njësinë vendore

Rezultati/Produkti	Aktivitete
<p>3.1.1 Ngritja e sistemit të integruar të informacionit në nivel lokal, për te identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesit shoqëror.</p> <p>3.1.2 Ofrimi i shërbimeve në trajtimin e problemeve dhe integrimin e grupeve vulnerabël në shoqëri bëhet në mënyrë efektive.</p> <p>3.1.3 Rritja e bashkëpunimit të pushtetit vendor me donatorë të cilët ofrojnë mbështetje në shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor.</p> <p>3.1.4 Ngritja ose nxitja e mekanizmave që mund të ofrojnë mbështetje për grupet vulnerabël për integrimin e tyre ne jetën shoqërore dhe krijimin e pavarësisë nga ana ekonomike.</p>	<p>3.1.1.1 Organizimi i takimeve nga një grup specialistësh për të vlerësuar nevojat që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social për grupe të ndryshme si dhe koordinimi i punës së këtyre qendrave .</p> <p>3.1.1. 2 Paraqitja e një harte të qartë mbi shtrirjen që kanë qendrat që ofrojnë shërbime të kujdesit social dhe gjendjen në të cilën ndodhen këto qendra</p> <p>3.1.2.1 Rritje të kapaciteteve profesionale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në përputhje me standartet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse.</p> <p>3.1.3.1 Trajnime për stafet që ofrojnë shërbime të kujdesit social në njësitë vendore, për rritjen e kapaciteteve profesionale</p> <p>3.1.4.1 Promovimin i modeleve të reja të shërbimeve sociale nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta.</p> <p>3.1.4.2 Organizimi i takimeve nga pushtetit vendor me përfaqësues të biznesit apo OJQ-ve për të parë mundësinë për rritjen e fondeve për këto shërbime.</p> <p>3.1.4.3 Realizimi i takimeve me agjencitë e formimit profesional apo shkollat dhe bizneset për të parë mundësitë që ofrojnë për kurse profesionale apo edhe mundësi punësimi.</p> <p>3.1.4.4 Ngritja e njësisë së hartimit të politikave sociale pranë organeve të bashkisë e përbërë nga tre specialistë të politikave sociale, që adresojnë problemet sociale.</p>
Objektivi 3.2 Rritja e cilësisë së shërbimeve që ofrohet nga qendrat e kujdesit social për një efektivitet me të madh për përdoruesit e shërbimeve.	
Rezultati/Produkti	Aktivitete

<p>3.2.1 Shtrirja e shërbimeve dhe ofrimi i shërbimeve në afërsi me vendbanimin e personave që kanë nevojë për kujdes social</p> <p>3.2.2 Krijimi i një sistemi kualifikimi dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale për të ofruar një shërbim sa më efektiv në dobi të personave që përfitojnë shërbime të kujdesi social.</p> <p>3.2.3 Rritja e transparencës mbi mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të qendrave që ofrojnë shërbime të kujdesit social.</p> <p>3.2.4 Ndërgjegjësimi i përdoruesve të shërbimit për tu bërë pjesë e përmirësimit të shërbimeve të kujdesit social.</p> <p>3.2.5 Deinstitutionalizimi dhe fuqizimi i përdoruesve të shërbimeve të kujdesit social për tu angazhuar në skemën e punësimit dhe jetën shoqërore.</p> <p>3.2.6 Menaxhimi i shërbimeve nëpërmjet krijimi të një databaze për secilën qendër që ofron shërbime të kujdesit social dhe mundësia për të ndërhyrë në të ardhmen duke bërë vlerësimin e raportimeve.</p> <p>3.2.7 Zhvillimi dhe integrimi i sistemit të mirëqenies sociale në favor të grupeve në nevojë</p>	<p>3.2.1.1 Ndërtimi i qendrave informuese, këshilluese dhe ndihmëse për individë që janë përdorues të shërbimeve të kujdesit social.</p> <p>3.2.2.1 Trajnime për përmirësimin e aftësive profesionale dhe mjeshtërive komunikuese për stafin e punësuar aktualisht, por gjithashtu lidhet me zgjerimin e këtij stafi me profesionistë të profesioneve të reja.</p> <p>3.2.3.1 Ngritja e një komisioni të përbërë nga tre persona që merren me monitorimin periodik të cilësisë së shërbimeve dhe raportimin mujor pranë zyrës përkatëse.</p> <p>3.2.4.1 Sesione informuese me personat që përdorin shërbime të kujdesit social për mënyrën se si mund të veprojnë në rast se ju shkelen të drejtat e tyre.</p> <p>3.2.5.1 Trajnimi i përdoruesve të shërbimeve të kujdesit social për tu integruar në jetën social-ekonomike dhe nxitjen e pavarësisë.</p> <p>3.2.6.1 Sesione informuese për stafin në lidhje me raportimet e dokumentuara që duhet të kenë pranë zyrës së tyre dhe rëndësinë që mbartin këto raportime mujore.</p> <p>3.2.7.1 Realizimi i një studimi për të vlerësuar hendekun e nevojave për shërbime sociale krahasuar me shërbimet e ofruara.</p>
<p>Objektivi 3.3 Nxitja dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve e të rinjve dhe integrimi i tyre në shoqëri.</p>	
<p>Rezultati/Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>3.3.1 Ngritja e shërbimit të kujdesit social për fëmijët si njësi më vete në secilën njësi vendore me staf të dedikuar.</p> <p>3.3.2 Fuqizimi dhe sensibilizimi i mekanizmave mbi rolin e rëndësishëm që ka koordinimi i punës së tyre në mbrojtje të drejtave të fëmijëve.</p> <p>3.3.3 Rritja e kapaciteteve profesionale për mënyrën e</p>	<p>3.3.1.1 Ngritja e komisionit për identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e nevojave që kanë fëmijët në secilën njësi vendore.</p> <p>3.3.2.1 Trajnime dhe fushat sensibilizimi.</p> <p>3.3.3.1 Trajnime mbi mënyrën e identifikimit dhe referimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve me punonjësit e njësive administrative, me mjekët e familjes, me</p>

<p>të vepruarit dhe adresimin e problemeve të fëmijëve duke ulur numrin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve</p> <p>3.3.4 Respektimi i të drejtave të fëmijëve duke ju garantuar jetën dhe duke ju ofruar asistencë dhe mbrojtje sociale të përshtatshme sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve.</p> <p>3.3.5 Rritja e kapaciteteve profesionale për mënyrën e të vepruarit dhe adresimin e problemeve të të rinjve me qëllim përfshirjen e tyre në jetën sociale e ekonomike të Bashkisë dhe orientimin e tyre drejt formimit profesional.</p> <p>-Rritja e bashkëpunimit dhe e advokacisë për buxhetim me fokus fëmijët dhe të rinjtë.</p> <p>3.3.6 Fuqizimi dhe sensibilizimi i mekanizmave lokalë në drejtim të punës me të rinjtë duke synuar ndalimin e largimit të tyre nga vendi</p> <p>- Advokim për buxhetim me fokus të rinjtë</p>	<p>punonjësi e policisë në komunitet, me mësuesit, me psikologë apo punonjësit socialë që ndodhen në shkollë apo edhe në qendra të ofrimit të kujdesit social, me përfaqësues të qeverive të nxënësve.</p> <p>3.3.4.1 Ngritja e qendrave komunitare dhe pajisja e tyre me të gjitha standartet për shërbimet ditore për fëmijët e të rinjtë në nevojë, si dhe rekrutimi i stafit përgjegjës.</p> <p>3.3.5.1 Organizmi i takimeve ndërgjegjësuere me prindërit e fëmijëve dhe të rinjve në nevojë apo persona përgjegjës për ta</p> <p>3.3.5.2 Ngritja e një qendre rinore që do ndihmojë ata të nxjerrin në pah aftësitë e tyre nëpërmjet frekuentimit të kurseve profesionale</p> <p>3.3.5.3. Ngritja e terrerave sportive pranë qendrave të shkolle dhe në lagjet e qytetit.</p> <p>3.3.6.1 Ngritja e një qendre multifunksionale dhe pajisja e saj sipas standarteve dhe ofrimi i shërbimeve në mbështetje të të rinjve dhe nxitjen e tyre për të marrë iniciativa individuale dhe në grup për përmirësimin e situatës socio-ekonomike të tyre.</p>
<p>Objektivi 3. 4 Ndërgjegjësimi i autoriteve lokale dhe komunitetit për problematikat e moshës së tretë.</p>	
<p>Rezultati/Produkti</p> <p>3.4.1 Ofrimi i mbështetjes për një komunitet të shëndetshëm ku të moshuarit të kenë mundësi të jenë të sigurtë dhe të qetë, të përfshihen dhe të jetojnë me dinjitet në shoqëri.</p> <p>3.4.2 Aktivizimi i të rinjve për të dhënë kontributin e tyre në shoqëri për nevojat specifike që paraqesin të moshuarit në jetën e tyre të përditshme.</p> <p>3.4.3 Rritja e përfshirjes dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për të ofruar kontributin e tyre shoqëror në shërbim të të moshuarve.</p>	<p>Aktivitete</p> <p>3.4.1 .1 Evidentimi i nevojave emergjente të të moshuarve për të cilat kërkohet ndërhyrje e qendrave të shërbimeve të kujdesit social apo dhe komuniteti.</p> <p>3.4.2.1 Ngritja dhe trajnimi e një rrjeti të rinjsh vullnetarë që ndihmojnë të moshuarit me shërbime në familje apo dhe aktivitete ditore në secilën njësi vendore.</p> <p>3.4.3.1 -Sesione ndërgjegjësuere me komunitetin mbi dobishmërinë që ato kanë dhe për të ardhmen jo pozitive nëse nuk parandalohet sot problemet e të moshuarve.</p> <p>3.4.4.1 Krijimi i ambienteve socializuese dhe integruese për të moshuarit që të ndihen të</p>

<p>3.4.4 Përmirësimi i jetës social-shëndetësore dhe kulturore të të moshuarve në territorin e bashkisë dhe njësive vendore.</p> <p>3.4.5 Rritja e bashkëpunimit me median për të publikuar mesazhe sensibilizuese për shoqërinë dhe paraqitjen e situatës së të moshuarve.</p> <p>3.4.6 Koordinimi dhe bashkëpunimi i autoriteteve lokale dhe OJQ-ve që veprojnë në Elbasan për të ndërhyrë me situatat më emergjente të të moshuarve</p>	<p>përfshirë në jetën shoqërore.</p> <p>3.4.5.1 Krijimi i bashkëpunimit me televizione lokale apo kombëtare për të përfshirë në emisionet e tyre çështjet e të të moshuarve</p> <p>3.4.6.1 Hartimi i raporteve gjashtë mujore nga secila njësi vendore për të paraqitur sfidat dhe problemet konkrete të të moshuarve.</p> <p>3.4.6.2 Ngritja e shërbimeve të kujdesit në familje për të moshuarit.</p>
<p>Objektiva 3. 5 Inkurajimi i grave për të qenë të përfshira në vendimmarrje dhe për të raportuar rastet e shkeljes së drejtave të tyre</p>	
<p>Rezultati/Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>3.5.1 Adresimi i problemeve që paraqesin gratë në nevojë për ndërhyrje sociale nga autoritet e pushtetit lokal, OJQ, edhe nga komuniteti në të cilin jetojnë këto gra.</p> <p>3.5.2 Rritja e ndërgjegjësimit nga ana e publikut për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e situatës së grave si një faktor pozitiv për shoqërinë.</p> <p>3.5.3 Informimi i grave dhe ndërgjegjësimi burrave për ti thënë STOP dhunës ndaj gruas dhe ulja e numrit të grave të keqtrajtuara.</p> <p>3.5.4 Rritja e numrit të grave të punësuar në punë të paguara dhe përfshirja e tyre në vendimmarrjen shoqërore duke respektuar kuadrin ligjor.</p> <p>3.5.5 Koordinimi dhe bashkëpunimi i institucioneve lokale për intergrimin dhe fuqizimin e grave të cilat kanë nevojë për mbështetje për të ndryshuar situatën e tyre social-ekonomike.</p> <p>3.5.6 Ofrimi i shërbimeve cilësore për gratë e dhunuara dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të shërbimeve për një integrim sa më të sigurt të</p>	<p>3.5.1.1 Vlerësimi nga ekspertë që merren me çështjet gjinore për nevojat dhe problemet që paraqesin gratë në secilën njësi vendore për të parë nevojën për ndërhyrje.</p> <p>3.5.2.1 Përgatitja e materiale informuese si fletëpalosje, postera, spote publicitare dhe emisione televizive për parandalimin e keqtrajtimit të grave.</p> <p>3.5.3.1 Organizimi i sesioneve ndërgjegjësuere me gra dhe burra në secilën njësi të qeverisjes vendore për ti thënë STOP dhunës ndaj gruas, si dhe informimin për mënyrën e të vepruarit në një rast abuzimi.</p> <p>3.5.4.1 Shumëfishimi i trajnimeve që u interesojnë grave në të gjitha sferat e shtrirjes në shoqëri për tu bërë pjesë e vendimmarrjes në shoqëri.</p> <p>3.5.5.1 Organizimi i takimeve me pjesëmarrës OJQ që veprojnë në Kukës si dhe përfaqësues të ofrimit të shërbimit të kujdesit social për gratë për të bërë të mundur koordinimin e punës së tyre për të ofruar një shërbim sa më cilësor për gratë.</p> <p>3.5.6.1 Zgjerimi i shërbimeve këshilluese dhe rehabilituese, strehëzave për gratë të cilat vuajnë nga keqtrajtimet dhe pajisja e tyre me staf të kualifikuar.</p> <p>3.5.7.1 -Organizimi i diskutimeve të hapura nga organet e pushtetit vendore për respektimin e kuaotave gjinore në këshillat bashkiakë.</p>

<p>këtyre grave në shoqëri. 3.5.7 Respektimi i kuotave gjinore në këshillin bashkiak si një formë e mirëqeverisjes së pushtetit vendor për ofrimin e shanseve të barabarta</p>	
<p>Objektiva 3.6 Ndërtimi i një ambienti shoqëror të shëndetshëm për komunitetin rom dhe egjiptian përmes fushatave të ndërgjegjësimit social-kulturor dhe shëndetësor për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.</p>	
<p>Rezultati/Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>3.6.1 Rritja e bashkëpunimit të pushtetit vendor me shoqërinë civile për të ofruar sa më shumë shërbime social-ekonomike në ndihmë të komunitetit rom dhe egjiptian për një jetë më të sigurt dhe të qetë. 3.6.2 Informimi i komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e pushtetit vendor në programet e mbështetjes sociale dhe procedurat për të përfituar nga këto programe si një formë për integrimin dhe rritjen e përfshirjes në jetën shoqërore ku ata jetojnë 3.6.3 Ofrimi i mundësive që familjet e komunitetit rom dhe egjiptian të bëhen përfitues të skemës së banesave sociale duke ndryshuar kriteret që i bëjnë përfitues ata. 3.6.4 Fuqizimi dhe integrimi i të rinjve/rejave në skemat e punësimit dhe rritja mundësive për të krijuar pavarësinë e tyre social-ekonomike në jetën e përditshme. 3.6.5 Informimi dhe ndërgjegjësimi i familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian me këshilla praktike mbi mënyrën e të vepruarit dhe të raportuarit në situata të ndryshme.</p>	<p>3.6.1.1 Realizimi i një studimi të detajuar për komunitetin rom dhe egjiptian për të parë situatën në të cilën ata ndodhen duke përfshirë arsimin, punësimin, gjendjen shëndetësore, strehmin, ushqimin etj. 3.6.2.1 Mbështetje dhe asistencë e rritur nga njësitë e pushtetit vendor për të gjitha familjet e komunitetit rom dhe egjiptian që kërkojnë të përfshihen në skemat e shërbimit social për pagesat e ndihmës ekonomike, pagesat për personat me aftësi të kufizuar, për banesat sociale. 3.6.3.1 Organizimi i diskutimeve me përfaqësues të autoriteteve lokale dhe këshillit bashkiakë për të rritur aksesin e komunitetit rom dhe egjiptian për të përfituar nga skema e banesave sociale. 3.6.4.1 Ofrimi i kurseve profesionale në qendrat e formimit profesional për të rinjtë dhe të rejtat romë dhe egjiptiane për tu bërë pjesë e skemave të punësimit. 3.6.5.1 Seminare të mbajtura nga staf profesional me familje të komunitetit rom dhe egjiptian mbi çështje të arsimit, konflikteve në familje, komunikimin dhe dialogun, të drejtave të tyre etj.</p>
<p><i>Objektivi 3.7 Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajnimin profesional</i></p>	
<p>Rezultati/Produkti</p>	<p>Aktivitete</p>
<p>3.7.1 Garantimi për akses të barabartë të komunitetit</p>	<p>3.7.1.1 Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, pushtetit</p>

<p>rom dhe egjiptian në sistemin arsimor.</p> <p>3.7.2 Integrimi dhe rritja e numrit të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian të përfshirë në skemat e punësimit.</p> <p>3.7.1 Rritja e numrit të projekteve në favor të komunitetit rom dhe egjiptian dhe e numrit të përfituesve.</p> <p>3.7.4 Rritja e fushatave ndërgjegjësuese dhe rritja e numrit të personave si punëkërkuar të regjistruar në fillim dhe në fund të fushatave.</p> <p>3.7.5 Fuqizimi dhe shtimi i numrit të biznese të vogla apo edhe të mëdha me sipërmarrës persona të komunitetit rom dhe egjiptian.</p>	<p>vendor dhe ministrisë së arsimit për ofrimin e mundësive të barabarta për fëmijët e komunitetit.</p> <p>3.7.2.1 Nxitja e komunitetit rom dhe egjiptian për të ndjekur kurse profesionale për tu përfshirë në skema e punësimit si profesionistë.</p> <p>3.7.3.1 Financimin e projekteve të zhvillimit ekonomik që u mundësojnë komunitetit rom dhe egjiptianët për të kaluar pragun e varfërisë</p> <p>3.7.4.1 Organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese me të papunët rom dhe egjiptian mbi mundësitë dhe përfitimet nga programet e punësimit dhe formimit profesional.</p> <p>3.7.5.1 Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për sipërmarrësit rom dhe për pjesëmarrësit në programet e gjenerimit të të ardhurave.</p>
--	--

